

Vendim nr. 69, datë 04.06.2026

(V- 69/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 28.04.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (R) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **RENISA SELENICA**, përfaqësuar nga avokati Loren Liço, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

SAMUËL SOARES, përfaqësuar nga avokati Nexhat Spahiu, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5442, datë 18.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2024-5194 (851), datë 23.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 8, 18, 38, 39, 42, 116, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 2 i Protokollit nr. 4 dhe neni 5 i Protokollit nr. 7 të saj; ligji nr. 9443, datë 16.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e

fëmijëve””; ligji nr. 9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës””; nenet 27-30, 39, 42 dhe 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Renisa Selenica (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Samuël Soares, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është shtetase shqiptare, e cila ka qenë e martuar me subjektin e interesuar, Samuël Soares, shtetas belg. Martesa e tyre është lidhur në Belgjikë dhe nga ajo ata kanë një fëmijë të mitur, i cili ka lindur në Belgjikë në vitin 2020. Fëmija është regjistruar në Belgjikë, në regjistrin e gjendjes civile, me shtetësi belge, në bazë të ligjit belg për shtetësinë. Familja ka jetuar në Belgjikë.

2. Në korrik të vitit 2022 të dy prindërit dhe fëmija kanë udhëtuar në Shqipëri për pushime, me kthim të planifikuar më 11.08.2022. Pas një mosmarrëveshjeje mes bashkëshortëve subjekti i interesuar është kthyer i vetëm në Belgjikë në datën 29.07.2022, ndërsa kërkuessa ka qëndruar në Shqipëri bashkë me fëmijën dhe, në datën 10.08.2022, i ka bërë të ditur bashkëshortit vendimin e saj për të mos u kthyer më në Belgjikë dhe për zgjidhjen e martesës së tyre. Në vijim, kërkuessa e ka regjistruar fëmijën në regjistrat e gjendjes civile, në Shqipëri, me shtetësi shqiptare, në bazë të ligjit shqiptar për shtetësinë.

3. Pas situatës së krijuar, kërkuessa ka vënë në lëvizje, në Shqipëri, një proces gjyqësor për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka vënë në lëvizje, në Belgjikë, një procedurë për kthimin e fëmijës në Belgjikë, në kuadër të së cilës, në Shqipëri, është zhvilluar edhe një proces gjyqësor. Po kështu, ai ka vënë në lëvizje, në Belgjikë, edhe një proces gjyqësor për zgjidhjen e martesës dhe për kujdestarinë e fëmijës.

i) Procedura për kthimin e fëmijës në Belgjikë

4. Në datën 16.08.2022 subjekti i interesuar, Samuël Soares, u është drejtuar autoriteteve të shtetit belg, duke kërkuar kthimin e fëmijës në vendin ku kishte qëndrimin e përhershëm. Mbështetur në Konventën e Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës” (*Konventa për Rrëmbimin e Fëmijës*), autoriteti qendror belg për bashkëpunimin në çështje civile, me shkresën nr. 3190/1 prot., datë 18.10.2022, u ka kërkuar autoriteteve shqiptare ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për kthimin e fëmijës në vendqëndrimin e përhershëm, në Belgjikë, duke vlerësuar se nëna e fëmijës (kërkuesja) ka shkelur dispozitat e konventës në fjalë.

5. Në datën 20.10.2022, mbështetur në nenin 7 të Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, në të cilën shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka paraqitur përpara gjykatës së shkallës së parë kërkesën e babait të fëmijës të përcjellë nga autoritetet belge, për kthimin e fëmijës në vendqëndrimin e përhershëm në Belgjikë. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6031, datë 30.11.2022, ka urdhëruar kërkuesen të kthejë fëmijën në vendbanimin e përhershëm në Belgjikë. Ky vendim, pas ankimit të kërkueses, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 61, datë 08.03.2023, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2527, datë 12.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses. Kjo e fundit ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme dhe Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 67, datë 25.03.2025 (*vendimi nr. 67/2025*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke i vlerësuar si haptazi të pabazuara pretendimet e kërkueses.

6. Në lidhje me ekzekutimin e vendimit, ndonëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka disponuar për ekzekutimin e përkohshëm të tij dhe për këtë është në lëvizje një procedurë ekzekutimi, pas ankimit të kërkueses, me vendimin nr. 149, datë 23.01.2023, ajo gjykatë ka urdhëruar pezullimin e procedurës së ekzekutimit deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në themel me vendim gjyqësor të formës së prerë. Procedura e ekzekutimit është aktivizuar sërish menjëherë pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, por kthimi i fëmijës në Belgjikë është realizuar vetëm në datën 18.06.2025. Ndërkohë, megjithëse kërkuesja e ka kundërshtuar procedurën e ekzekutimit, sipas të dhënave të ofruara nga subjekti i interesuar, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr.

4555, datë 10.07.2025, ka vendosur mospranimin e ankimit të saj, proces gjyqësor për të cilin palët nuk kanë ofruar informacion të mëttejshëm.

ii) Procesi gjyqësor në Belgjikë për zgjidhjen e martesës dhe kujdestarinë e fëmijës

7. Në datën 30.09.2022, subjekti i interesuar, Samuël Soares, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Anversës, Belgjikë, duke i kërkuar zgjidhjen e martesës dhe kujdestarinë e fëmijës. Çështja është regjistruar në datën 03.10.2022. Ndonëse kërkesja është njoftuar rregullisht për seancën gjyqësore, ajo nuk është paraqitur në gjykim, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej saj. Ndërkohë, për kërkesën e subjektit të interesuar, për marrjen e masave paraprake, gjykata belge, me vendimin e datës 25.10.2022, i ka njohur përkohësisht subjektit të interesuar të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke përcaktuar se fëmija duhet të qëndronte në adresën e subjektit të interesuar, e cila do të konsiderohej si vendbanimi kryesor. Në këtë rast, duke vënë në dukje se një proces i tillë ishte vënë në lëvizje edhe në Shqipëri nga kërkesja, gjykata belge ka vlerësuar se, bazuar në nenet 5 dhe 7 të Konventës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin për përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” (*Konventa për Përgjegjësinë Prindërore*), në parashikimet e legjislacionit belg, si dhe në faktin se fëmija kishte vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Belgjikë, ajo kishte juridiksion për shqyrtimin e çështjes.

iii) Procesi gjyqësor në Shqipëri për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën (objekt i ankimit kushtetues individual)

8. Në datën 05.08.2022 kërkesja i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi për zgjidhjen e martesës dhe lënien e fëmijës asaj për rritje dhe për edukim. Gjatë këtij procesi gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, mbështetur në nenin 16 të Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, i ka kërkuar gjykatës pezullimin e gjykimit të çështjes derisa të vendosej se fëmija nuk do të kthehej sipas kësaj konvente. Ndonëse gjykata nuk ka marrë formalisht një vendim pezullimi, procesi gjyqësor ka vijuar përgjatë disa seancave, duke përfunduar vetëm pasi Gjykata e Lartë ka dhënë vendimin në procesin gjyqësor për kthimin e fëmijës në Belgjikë. Po kështu, gjatë gjykimit të çështjes, subjekti i interesuar, Samuël Soares, përmes përfaqësuesit të tij, i ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë që për kërkimin e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, të vendosë nxjerrjen e këtij kërkitimi jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar. Sipas tij, çështja kishte elemente të huaja për shkak të subjektit, pasi ai (subjekti i interesuar) ishte shtetas belg, si dhe për shkak të përmbajtjes së marrëdhënies

juridike, duke qenë se martesë ishte lidhur në Belgjikë, bashkëshortët kishin pasur vendqëndrimin e zakonshëm në këtë shtet, fëmija kishte lindur në Belgjikë dhe kishte shtetësi belge, duke pasur aty edhe vendqëndrimin e zakonshëm, ndërkohë që në Belgjikë po zhvillohej një proces gjyqësor me të njëjtin objekt.

9. Në përfundim të gjyqësorit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 5442, datë 18.09.2024, pasi ka pranuar kërkimin e padisë për zgjidhjen e martesës mes bashkëshortëve ndërgjyqës, ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Për këtë disponim të fundit, ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se, në kushtet kur me vendim gjyqësor përfundimtar ishte vendosur kthimi i fëmijës në vendbanimin e tij të përhershëm në Belgjikë, bazuar në nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, në të cilën shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, në ligjin nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” (*Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private*) dhe në nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), gjykatat shqiptare nuk kishin juridiksion për shqyrtimin e këtij kërkit. Kundër këtij vendimi, për pjesën që nxirrte jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar këtë kërkim, kërkuësja ka ushtruar rekurs të veçantë, ndërsa subjekti i interesuar ka paraqitur kundërrkurs.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5194 (851), datë 23.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pjesën që ka disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në mënyrë të përmbledhur, ai ka arsyetuar se çështja paraqiste një marrëdhënie juridike me elemente të huaja, për shkak të shtetësisë së palëve dhe të fëmijës, si dhe të vendqëndrimit të subjektit të interesuar në Belgjikë. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, pavarësisht se kërkit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ishte paraqitur në kuadër të procesit për zgjidhjen e martesës, në prani të elementeve të huaja përcaktimi i juridiksionit për këtë kërkim duhej bërë duke mbajtur parasysh rregullat e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore. Në këtë drejtim, ajo ka mbajtur parasysh se fëmija kishte pasur vendqëndrimin e zakonshëm familjar në Belgjikë, se gjykatat shqiptare, në procedurën për kthimin e fëmijës, sipas Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, kishin urdhëruar kthimin e tij në Belgjikë dhe se gjendja faktike e krijuar nga qëndrimi i fëmijës në Shqipëri nuk mund të shërbente për pranimin e juridiksionit gjyqësor shqiptar për këtë kërkim. Mbi këtë bazë, duke iu referuar neneve 5 dhe 7 të Konventës për

Përgjegjësinë Prindërore, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ky kërkim nuk përfshihej në juridiksionin gjyqësor shqiptar.

11. Në datën 09.04.2025 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankimin kushtetues individual, sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ky ankim, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 19.05.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 15.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

12.1. *Detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur të drejtat e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, e drejta për të zgjedhur lirisht vendbanimin, si dhe e drejta për të mos u dëbuar nga territori i shtetit, të garantuara nga nenet 8, 38 dhe 39 të Kushtetutës, pasi:*

12.1.1. Në nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, në thelb, gjykatat i kanë dëbuar atë dhe fëmijën jashtë territorit shqiptar, pa marrë parasysh parashikimet e nenit 12, paragrafi i dytë, të Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, nenit 13 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, nenit 76 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, neneve 226 e 263 të Kodit të Familjes (*KF*) dhe nenit 38 të KPC-së, duke ia lënë zgjidhjen e çështjes së juridiksionit një shteti tjetër. Po kështu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 të *KF*-së dhe nenet 3, pika 1, e 7 të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës”. Fëmija kishte shtetësi shqiptare dhe ishte i regjistruar në Shqipëri, ku kishte vendbanimin e përhershëm. Në kushtet kur kërkesa e paraqitur nga ish-bashkëshorti në Belgjikë për zgjidhjen e martesës ishte pushur për shkak të procesit të nisur në Shqipëri, sipas nenit 226 të *KF*-së, gjykata shqiptare që kishte juridiksion për zgjidhjen e martesës, kishte juridiksion edhe për rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën. Po kështu, për sa kohë padia për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e

pasojave të saj ishte paraqitur më parë përpara gjykatës shqiptare, gjykatat duhej të merrnin në konsideratë edhe nenin 13 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore lidhur me proceset paralele për masat mbrojtëse. Për më tepër, vendimi i gjykatës belge për ushtrimin e përkohshëm të përgjegjësisë prindërore nga babai nuk i ka hequr asaj të drejtën e ushtrimit të kësaj përgjegjësie. Duke e nxjerrë këtë kërkim jashtë juridiksionit gjyqësor, gjykatat nuk kanë përcaktuar se me cilin prind do të qëndronte fëmija.

12.1.2. Në kundërshtim me nenet 12, paragrafi i dytë, dhe 13 të Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, autoritetet shqiptare kanë zbatuar forcërisht vendimin për kthimin e fëmijës, edhe pse kishte kaluar afati ligjor 1-vjeçar i parashikuar nga kjo konventë. Fëmija nuk fliste gjuhën flamande dhe ishte integruar në sistemin arsimor dhe edukativ në Shqipëri, pra ishte vendosur në një mjedis të ri. Ish-bashkëshorti nuk kishte kontribuar për rritjen e fëmijës, nuk kishte shprehur dëshirë për t'u takuar me dhe, edhe sipas aktit të ekspertimit psikologjik, fëmija duhet t'i lihej për rritje dhe edukim kërkuese. Në vendimmarrjet e tyre për kthimin e fëmijës, gjykatat nuk kanë verifikuar nëse fëmija ishte vendosur në një mjedis të ri, nuk kanë marrë parasysh mendimin profesional të ekspertit, nuk kanë hetuar për pretendimet e saj për sjelljen e ish-bashkëshortit dhe nuk kanë marrë parasysh refuzimin e fëmijës për t'u kthyer. Kërkuese e është mohuar e drejta për t'u takuar me fëmijën, ndërsa është proceduar penalisht nga autoritetet belge, duke u mbajtur në paraburgim.

12.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.2.1. *Standardit të arsytimit të vendimit* gjyqësor, pasi:

i) Gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 5 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, ndërkohë që, sipas kërkuese, kjo dispozitë nuk është detyruese për zgjidhjen e pasojave të martesës. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato kishin të bënin me shkelje të standardeve kushtetuese. Interpretimi që ajo u ka bërë neneve 12, 13 e 14 të Kodit Civil (KC) dhe Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private është i gabuar. Ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuese për juridiksionin e gjykatave

shqiptare sipas nenit 226 të KF-së, nenit 76 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, nenit 10 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, si dhe për efektin e nenit 13 të kësaj konvente në kushtet e proceseve paralele.

ii) Arsyetimi se fëmijës nuk i është dhënë mundësia të kthehet e të qëndrojë në vendbanimin e tij të përhershëm dhe se mbahet në mënyrë të paligjshme prej kërkueses, është i gabuar. Sipas saj, në përputhje me parashikimet konventore, ajo i është drejtuar zyrës së përmbarimit për përmbushjen e detyrave në ekzekutimin e vendimit. Në këtë drejtim, ajo ka kërkuar marrjen nga autoritetet e vendqëndrimit të fëmijës të një informacioni social për fëmijën, të raportit të Njesisë së Mbrojtjes dhe Përkrahjes Sociale për kontaktet e këtij institucioni me subjektin e interesuar, përfundimet e dala nga këto takime, kushtet, afërsinë prindërore, vlerësimin psikologjik të prindërve e të fëmijës, si dhe marrjen e informacionit nga organi qendror i vendit tonë dhe nga Zyra e Shërbimit Social. Sipas kërkueses, mosekzekutimi i vendimit të autoriteteve belge ka qenë rrjedhojë e mospërmbushjes së detyrimeve nga organi qendror shqiptar dhe zyra e përmbarimit. Në këtë situatë, mbajtja e fëmijës në Shqipëri nuk mund të konsiderohej e paligjshme, ndaj, deri në ekzekutimin e vendimit për kthimin e tij, gjykata shqiptare kishte juridiksion për të vendosur për kërkimin në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

12.2.2. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur për çështjen e juridiksionit pas tre vjetësh, ndërkohë që duhet ta kishte bërë atë që në momentin e ngritjes së padisë.

13. Subjekti i interesuar, Samuël Soares, ka prapësuar se:

13.1. Pretendimet janë të pabazuara, pasi regjistrimi i fëmijës në Shqipëri nuk ndryshonte vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Belgjikë. Në nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykatat kanë vepruar në përputhje me nenin 1, paragrafi 2, të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe nenet 5 e 6 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore. Në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës dhe së drejtës së tij për jetë familjare, në datat 25.10.2022 dhe

04.04.2023 gjykatat belge kanë pranuar kërkesën e tij për ushtrimin e përkohshëm të përgjegjësisë prindërore. Kërkuesja ka marrë njoftim për seancën e zhvilluar në datën 25.10.2022, por nuk është paraqitur në gjykim, ndërsa ka qenë e përfaqësuar në seancën e datës 04.04.2023.

- 13.2. Pretendimet për cenimin e së drejtës për *proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë arsyetuar drejt për çështjen, në përputhje me nenet 37, paragrafi i dytë, dhe 57 të KPC-së, duke dhënë argumente për shkaqet e nxjerrjes së këtij kërkimi jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar. Po kështu, vendimet përmbajnë të gjitha elementet e parashikuara nga neni 310 i këtij kodi.
- 13.3. Kërkuesja ka refuzuar kthimin e fëmijës, duke e penguar atë (subjektin e interesuar) të ketë kontakte me fëmijën, si dhe duke vepruar në shkelje të së drejtës së tij të kujdestarisë, të njohur nga autoritetet belge, Konventa për Rrëmbimin e Fëmijës, Rregullorja nr. 2201/2003, datë 27.11.2003 e Bashkimit Evropian “Për juridiksionin dhe njohjen e zbatimin e vendimeve për çështjet martesore e të përgjegjësisë prindërore”, si dhe vendimet e autoriteteve shqiptare. Kërkuesja e ka regjistruar fëmijën në Shqipëri, pavarësisht se për këtë aplikim duhej edhe pëlqimi i tij. Në kundërshtim nga sa kërkuesja pretendon, në kthimin e fëmijës, gjykatat shqiptare kanë vepruar në mbrojtje të interesit më të lartë të tij, ndërsa vlerësimet psikologjike të ekspertit kanë qenë formale.
- 13.4. Në kushtet e moskthimit të fëmijës në Belgjikë dhe njohjes atij (subjektit të interesuar) të së drejtës së përkohshme për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga gjykatat belge, kërkuesja është vënë në kërkim ndërkombëtar dhe është ndaluar gjatë kalimit të kufirit shqiptar për në një shtet të Bashkimit Evropian. Ajo është vënë nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg” deri në momentin e përfundimit të hetimeve belge për veprat penale në ngarkim të saj, për të vijuar më pas me procesin civil për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Në kushtet kur fëmija është kthyer në Belgjikë, procesi i përcaktimit të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore do të zhvillohet tashmë përpara gjykatave belge.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Fillimisht, Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të dhëna në procesin për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën, në pjesën që është disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kerkimit për rregullimin e këtyre pasojave, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Megjithatë, në përmbajtjen e ankimit, kerkuesja ka ngritur pretendime edhe për procesin gjyqësor për kthimin e fëmijës në Belgjikë, si dhe për procedurat dhe vendimmarrjet e autoriteteve belge.

16. Për sa i përket procesit për kthimin e fëmijës në Belgjikë, Gjykata vëren se kerkuesja i është drejtuar më parë Gjykatës me ankim kushtetues individual. Për këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 67, datë 25.03.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke i vlerësuar pretendimet e kerkuseses si haptazi të pabazuara. Po kështu, kthimi i fëmijës sipas Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës përbën një procedurë të mëvetshme nga ajo për përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Kjo qasje përputhet edhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës një kërkesë për kthim sipas Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës është e ndryshme nga procedurat e kujdestarisë (*shih X kundër Letonisë [DhM], datë 26.11.2013, § 101*). Për rrjedhojë, duke qenë se pretendimet e kerkuseses për procesin e kthimit të fëmijës kanë qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ato nuk mund të merren sërish në shqyrtim në kuadër të ankimit kushtetues individual objekt i këtij gjykimi.

17. Për sa u përket procedurave dhe vendimmarrjeve të autoriteteve belge, Gjykata thekson se juridiksioni i saj kushtetues përcaktohet nga Kushtetuta dhe lidhet me kontrollin e akteve të pushtetit publik dhe të vendimeve gjyqësore që i përkasin rendit juridik shqiptar. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar

të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese. Ky kontroll ushtrohet për cenime që burojnë nga akte ose vendimmarrje të autoriteteve shqiptare, ndaj individëve, shtetas shqiptarë ose të huaj, për sa kohë ato bien brenda fushës së veprimit të rendit kushtetues dhe sistemit normativ shqiptar. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se, në aspektin juridiksional, territori shqiptar përfshin hapësirën ku institucionet publike të rendit tonë kushtetues ushtrojnë juridiksionin e tyre dhe ku gjen zbatim sistemi normativ shqiptar (*shih vendimin nr. 2, datë 29.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kontrolli i procedurave dhe i akteve të autoriteteve belge nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës. Në këtë kuadër, edhe pretendimi i kërkueses për cenimin e nenit 8 të Kushtetutës, për aq sa lidhet me detyrimin pozitiv të shtetit shqiptar për mbrojtjen e saj në raport me procedurat ose vendimmarrjet e autoriteteve belge, nuk mund të merret në shqyrtim në këtë proces kushtetues.

18. Për sa i takon procesit të zhvilluar nga gjykatat shqiptare për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën, në pjesën që është disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për rregullimin e këtyre pasojave, konkretisht për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, Gjykata çmon se kërkuessa, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në atë proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

19. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, si rregull, mund të aplikohet vetëm për vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se, në rastin konkret, sikurse u evidentua, objekti i ankimit kushtetues individual janë vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për atë pjesë që ka vendosur për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në aspektin formal, bëhet fjalë për një vendim gjyqësor jopërfundimtar, që nuk e ka zgjidhur në themel këtë kërkim,

por i ka dhënë fund shqyrtimit të tij përpara gjykatave shqiptare. Për vendimet e ndërmjetme, që nuk zgjidhin çështjen në themel, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se ato mund të bëhen, në mënyrë përjashtimore, objekt i kontrollit kushtetues kur: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të kundërshtuar; (ii) vendimi është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe është shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet si e cenuar; (iii) vendimi ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që vendimi përfundimtar nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë efektet e tij (*shih vendimet nr. 22, datë 04.04.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, edhe kur një vendim nuk zgjidh formalisht themelin e mosmarrëveshjes, ai mund të konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, nëse prodhon pasoja të drejtpërdrejta mbi ushtrimin e një të drejte kushtetuese dhe këto pasoja nuk mund të riparohen në mënyrë efektive nga vijimi i gjyqimit të themelit (*shih vendimin nr. 12, datë 18.03.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata çmon se vendimet e kundërshtuara, ndonëse formalisht nuk zgjidhin themelin e kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ato pengojnë vijimin e shqyrtimit të tij përpara gjykatave shqiptare. Për rrjedhojë, duhet të verifikohet nëse, nisur nga efektet konkrete që pretendohet se këto vendime kanë prodhuar mbi të drejtën e aksesit në gjykatë, plotësohen kriteret që lejojnë, përjashtimisht, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

22. Për sa i përket kriterit të parë, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuësës lidhet me faktin se vendimet e kundërshtuara, duke e nxjerrë kërkimin në fjalë jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, kanë penguar ushtrimin e së drejtës së aksesit në këto gjykata. Në këtë kuptim, shkelja e pretenduar lidhet drejtpërdrejt me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor që duhet të shqyrtojë kërkimin. Për rrjedhojë, kriteri i pasojës së drejtpërdrejtë konsiderohet i përmbushur. Për sa i përket kriterit të dytë, Gjykata vëren se për çështjen e juridiksionit është shprehur edhe Gjykata e Lartë, vendimi i së cilës nuk i nënshtrohet një mjeti tjetër ankimi në juridiksionin e zakonshëm. Për rrjedhojë, edhe ky kriter konsiderohet i përmbushur. Për sa i përket kriterit të tretë, vendimet e kundërshtuara kanë një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi një vendimmarrje e mëvonshme për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nuk është e aftë të ndryshojë përcaktimin për mungesën e juridiksionit gjyqësor shqiptar dhe as të riparojë plotësisht pasojën e pretenduar kushtetuese. Për më tepër, në një rast të ngjashëm, Gjykata ka pranuar se vendimi për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit

gjyqësor shqiptar përbën vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa më sipër, Gjykata çmon se, në rrethanat e rastit konkret, vendimet e kundërshtuara, ndonëse nuk kanë zgjidhur themelin e kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ato kanë natyrë përfundimtare për sa i përket përjashtimit të këtij kërkit nga shqyrtimi i gjykatave shqiptare. Me nxjerrjen e këtij kërkit jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, këto vendime i kanë dhënë fund shqyrtimit të tij përpara gjykatave shqiptare, ndërsa ky përcaktim është i detyrueshëm për to dhe nuk mund të ndryshohet më prej tyre, për sa kohë nuk ndryshojnë rrethanat mbi të cilat është mbështetur përcaktimi i juridiksionit. Për rrjedhojë, vendimet e kundërshtuara janë të afta të prodhojnë pasoja të drejtpërdrejta mbi të drejtën e kërkuar për akses në gjykatat shqiptare, ndaj ajo legjitimohet në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive.

24. Po në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka theksuar se ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme gjyqësore, por edhe që pretendimet t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet procedurale (*shih vendimet nr. 34, datë 17.03.2026; nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pretendimet për tejzgjatjen e gjykimit ose zvarritjen e procedurave, Gjykata ka theksuar se mjeti juridik efektiv, sipas *nenit 399/1 e vijues të KPC-së*, i përket fillimisht gjyqësorit të zakonshëm, ndërsa Gjykata investohet vetëm kur provohet se ky mjet nuk ka qenë efektiv. Për këtë arsye, individ duhet të tregojë kujdesin e duhur, duke përdorur në kohën e duhur kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*shih vendimet nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata vëren se, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (*shih sipër paragrafin 12.2.2. të këtij vendimi*), kërkuarja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi nuk rezulton të ketë përdorur më parë mekanizmat e parashikuar nga *nenet 399/1 e vijues të KPC-së* për konstatimin e cenimit të kësaj të drejte dhe përshpejtimin e gjykimit. Ndërsa pretendimet e tjera që lidhen me procesin objekt shqyrtimi kërkuarja i ka ngritur më parë, të paktën në substancë, në gjykatat e zakonshme, ndaj në lidhje me to ajo përmbush kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

26. Kërkuarja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që ka përmblyllur

procesin gjyqësor të kundërshtuar i është komunikuar në datën 13.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 09.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

27. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për të zgjedhur lirisht vendbanimin dhe së drejtës për të mos u dëbuar nga territori i shtetit, si dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara respektivisht nga nenet 38, 39, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

28. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për të zgjedhur lirisht vendbanimin dhe së drejtës për të mos u dëbuar nga territori i shtetit, të garantuara nga nenet 38 dhe 39 të Kushtetutës, Gjykata vëren se, për aq sa këto pretendime lidhen me kthimin e fëmijës në Belgjikë, ato kanë të bëjnë me procesin e kthimit të fëmijës sipas Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, i cili, për arsytet e parashtuara më sipër (*shih sipër paragrafin 17 të këtij vendimi*), nuk mund të merren sërish në shqyrtim në këtë gjykim kushtetues. Ndërsa, për aq sa kërkuuesja i lidh këto pretendime me pozitën e saj personale, ajo nuk ka parashtuar argumente që t'i vendosin ato brenda fushës së mbrojtjes së neneve 38 dhe 39 të Kushtetutës. Neni 38 garanton të drejtën e kujtëdo për të zgjedhur vendbanimin dhe për të lëvizur lirisht në territorin e shtetit, si dhe të drejtën për të dalë lirisht jashtë tij, ndërsa neni 39 ndalon dëbimin e shtetasit shqiptar nga territori i shtetit. Në rastin konkret, nuk rezulton ndonjë akt që ka kufizuar drejtpërdrejt lirinë e lëvizjes ose të zgjedhjes së vendbanimit të kërkueses dhe as ndonjë akt dëbimi ndaj saj nga territori i Republikës së Shqipërisë. Objekt i ankimit është vendimmarrja e gjykatave shqiptare për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ndërsa pasojat, që kërkuuesja i lidh me nenet 38 dhe 39 të Kushtetutës, janë të tërthorta dhe të varura nga vendimmarrje të tjera për këtë çështje. Për rrjedhojë, pretendimet për cenimin e neneve 38 dhe 39 të Kushtetutës janë haptazi të pabazuara.

29. Për sa i përket pretendimit të kërkueses se gjykata e shkallës së parë është shprehur për mungesën e juridiksionit në përfundim të procesit, Gjykata vëren se, për aq sa kjo rrethanë lidhet me kohëzgjatjen e gjykimit, ky aspekt është trajtuar më sipër në kuadër të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive (*shih sipër paragrafin 25 të këtij vendimi*). Ndërsa, për aq sa kjo rrethanë pretendohet si mangësi procedurale me ndikim kushtetues, Gjykata vëren se kërkuuesja nuk ka argumentuar që ajo të këtë prodhuar një pasojë të tillë në rrethanat e rastit konkret. Gjykata e Lartë ka pranuar se konstatimi i mungesës së juridiksionit në atë fazë nuk ishte në përputhje me momentin në të cilin gjykata duhej të kishte vlerësuar juridiksionin, por ka çmuar se kjo rrethanë nuk mund të përbënte shkak për prishjen e vendimit në këtë pjesë, për

sa kohë juridiksioni është parakusht procedural për shqyrtimin e kërimit. Nga ana tjetër, kërkuessa nuk ka argumentuar se momenti i këtij konstatimi i ka cenuar mundësinë efektive për të parashtruar pretendimet e saj për juridiksionin ose për të kundërshtuar vendimmarrjen përkatëse, e cila, në fakt, ka qenë objekt i rekursit të veçantë të kërkuesses dhe i shqyrtimit nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, në këtë aspekt, pretendimi është haptazi i pabazuar.

30. Ndërkohë, për sa u përket pretendimeve të mbetura të kërkuesses, duke mbajtur në konsideratë se ato, në thelb, kanë të bëjnë me mosshqyrtimin në themel nga gjykatat e zakonshme të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, Gjykata çmon të analizojë bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të *së drejtës së aksesit në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuessa ka pretenduar se në nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar gabim Konventën për Përgjegjësinë Prindërore, Ligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe dispozitat e KF-së, duke mos mbajtur parasysh as interesin më të lartë të fëmijës, të garantuar edhe nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Sipas saj, neni 5 i Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, të cilit i është referuar gjykata e shkallës së parë, nuk është detyrues për zgjidhjen e pasojave të martesës, ndërsa interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private është i gabuar. Sipas nenit 226 të KF-së, gjykata shqiptare që ka juridiksion për zgjidhjen e martesës ka juridiksion edhe për rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën. Po ashtu, sipas kërkuesses, gjykatat nuk kanë marrë parasysh nenin 76 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, nenin 10 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore dhe efektin e nenit 13 të kësaj konvente në kushtet e proceseve paralele. Për më tepër, vendimi i gjykatës belge për ushtrimin e përkohshëm të përgjegjësisë prindërore nga babai nuk i ka hequr asaj të drejtën e ushtrimit të kësaj përgjegjësie. Po sipas kërkuesses, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato ngrinin çështje për shkelje të standardeve kushtetuese.

32. Subjekti i interesuar, Samuël Soares, i ka prapësuar si të pabazuara pretendimet e kërkuesses, me argumentin se gjykatat kanë arsyetuar drejt për kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke dhënë përgjigje për shkaqet e nxjerrjes së tij jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar. Sipas tij, vendimmarrjet e kundërshtuara janë në përputhje me

Ligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe Konventën për Përgjegjësinë Prindërore, pasi regjistrimi i fëmijës në Shqipëri nuk ndryshonte vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Belgjikë. Po kështu, ai ka prapësuar se gjykatat belge i kanë njohur atij përkohësisht të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe se kjo vendimmarrje, së bashku me rrethanat e çështjes, është marrë në konsideratë nga gjykatat shqiptare në vlerësimin e juridiksionit. Për rrjedhojë, sipas subjektit të interesuar, juridiksioni për shqyrtimin e këtij kërkitimi nuk i përket gjykatave shqiptare. Për më tepër, duke qenë se fëmija është kthyer tashmë në Belgjikë, në vendqëndrimin e tij të zakonshëm, u takon gjykatave belge të vendosin për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 16.02.2026; nr. 50, datë 25.09.2025; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po kështu, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit edhe nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 50, datë 25.09.2025; nr. 28, datë 18.05.2023; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 35, datë 25.07.2011; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt, në rastet kur gjykatat e zakonshme kanë vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se dhënia e përgjigjes ndaj pretendimeve në rekurs merr rëndësi të veçantë në kushtet kur kjo vendimmarrje e tyre, duke mos e zgjidhur çështjen në themel, kufizon aksesin në gjykatë të individit (*shih vendimet nr. 23, datë 29.04.2021; nr. 18, datë 15.03.2016*).

të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, detyrimi për arsyetim nuk kërkon përgjigje të hollësishme për çdo argument të palëve, por kërkon që gjykata të japë përgjigje të mjaftueshme për pretendimet thelbësore dhe përcaktuese për zgjidhjen e çështjes.

35. Po sipas Gjykatës, kur pretendohet se vendimet gjyqësore objekt kontrolli përmbajnë elemente arbitrariteti, nuk vihet në dyshim e drejta e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë. Megjithatë, duke pasur si pikënisje të drejtën e kërkuarit për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element përbërës i së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe duke u kujdesur që në asnjë rast gjykimi kushtetues të mos marrë trajtën e një gjykimi të zakonshëm të shkallës së katërt, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, Gjykata kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore ose faktike të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit (që mbeten për t'u zgjidhur në sferën e gjykimit të gjykatave të zakonshme), por që gjithsesi cenonjë të drejtën e kërkuarit për të pasur një gjykim të drejtë (*shih vendimin nr. 11, datë 11.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata ka pohuar gjithashtu se në bazë të nenit 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit kur nuk pajtohen me të. Nën dritën e parashikimeve të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve (*shih vendimet nr. 45, datë 31.07.2025; nr. 3, datë 30.01.2024; nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme dhe duke mbajtur parasysh parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, veçanërisht i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 83, datë 18.12.2025; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 13, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata do të analizojë në vijim nëse vendimmarrjet e kundërshtuara, në pjesën që kanë nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, kanë cenuar të drejtën e kërkuarës për akses në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për këtë qëllim, Gjykata do të ndalet fillimisht në evidentimin e kuadrit ligjor në lidhje me përgjegjësinë prindërore në marrëdhëniet me elemente të huaja dhe, më pas, në arsytimin e vendimmarrjeve të kundërshtuara, për të

verifikuar në vijim nëse ato përmbushin standardin kushtetues të arsytimit në raport me të drejtën e aksesit në gjykatë.

38. Gjykata vë në dukje se Kushtetuta garanton të drejtën për martesë dhe familje, duke parashikuar se martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj (neni 53), si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve (neni 54). Në nivel ligjor, KF-ja parashikon se zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që prindërit kanë ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë kod (neni 154), si dhe se, pas zgjidhjes së martesës, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore bëhet sipas Kreut III “Pasojat e zgjidhjes së martesës” të këtij kodi (neni 226). Këto dispozita e vendosin ushtrimin e përgjegjësisë prindërore në kuadrin e pasojave të zgjidhjes së martesës, por nuk përcaktojnë rregulla të juridiksionit ndërkombëtar për rastet kur marrëdhënia juridike ka elemente të huaja.

39. Gjykata evidenton gjithashtu se, sipas KPC-së, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë kod dhe në ligje të veçanta, ndërsa juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të KPC-së dhe ligjeve të tjera. Po sipas KPC-së, juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit ose të ligjit (neni 36). Për sa u përket personave fizikë dhe juridikë të huaj, juridiksioni i gjykatave shqiptare rregullohet me ligj dhe nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç rasteve të parashikuara nga ligji ose nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (neni 37). KPC-ja parashikon, po ashtu, rregulla për rastet kur e njëjta padi, midis të njëjtave palë, me të njëjtin shkak dhe objekt, është duke u shqyrtuar njëkohësisht nga një gjykatë e shtetit të huaj dhe nga gjykata shqiptare, duke i njohur kësaj të fundit mundësinë e pezullimit të gjykimit, vijimit të tij ose pushimit të gjykimit në kushtet e parashikuara nga ligji (neni 38).

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private përcakton, ndër të tjera, rregullat për ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin e gjykatave shqiptare në marrëdhëniet juridike civile me elemente të huaja (neni 1). Sipas këtij ligji, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi dispozitat e tij, kur këto të fundit nuk pajtohen me to (neni 2). Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ky ligj parashikon se marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve rregullohen nga ligji i shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm ose nga ligji i shtetësisë së fëmijës, kur ky i fundit mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës (neni 29).

41. Për sa i përket juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private parashikon fillimisht rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit gjykatat

shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e posaçme të këtij ligji parashikojnë ndryshe (neni 71). Po ashtu, ligji parashikon juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare për kategori të caktuara çështjesh të lidhura ngushtësisht me territorin ose rendin juridik shqiptar, siç janë, ndër të tjera, çështjet mbi të drejta reale mbi sende të paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat shqiptarë ose ekzekutimi në Republikën e Shqipërisë i titujve ekzekutivë (neni 72). Gjithashtu, ligji njeh juridiksionin e caktuar me marrëveshje ose të pranuar përmes sjelljes procedurale të palës së paditur, kur ajo merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, në kushtet e parashikuara nga ligji (neni 73).

42. Krahës këtyre rregullave dhe jashtë kategorive të juridiksionit ekskluziv të parashikuara nga neni 72, Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private parashikon edhe rregulla të posaçme juridiksioni për fusha të caktuara të marrëdhënieve juridike civile me elemente të huaja, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe çështjet familjare. Kështu, në çështjet që lidhen me martesën, gjykatat shqiptare kanë juridiksion kur njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar, ose kur bashkëshorti kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë (neni 75, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”). Ky juridiksion shtrihet edhe mbi pasojat që vijnë nga zgjidhja e martesës, si dhe mbi masat e përkohshme që merren nga gjykata në këto raste (neni 75, pika 3). Po ashtu, për marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, ligji parashikon se gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë (neni 76).

43. Nga këto parashikime rezulton se Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private përmban rregulla të posaçme për juridiksionin e gjykatave shqiptare në çështjet familjare me elemente të huaja. Megjithatë, këto dispozita nuk përcaktojnë juridiksion ekskluziv të gjykatave shqiptare dhe nuk mund të lexohen të shkëputura nga rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Për rrjedhojë, në rastet që përfshihen në fushën e zbatimit të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, përcaktimi i juridiksionit për masat që lidhen me përgjegjësinë prindërore duhet të bëhet duke mbajtur parasysh edhe rregullat e kësaj konvente, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

44. Për sa i përket Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, Gjykata vëren se ajo ka për objekt, ndër të tjera, përcaktimin e shtetit, autoritetet e të cilit kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së tij, si dhe në përcaktimin e ligjit që duhet të zbatohet nga këto autoritete në ushtrimin e juridiksionit të tyre (neni 1, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”). Për qëllimet e kësaj konvente, termi “përgjegjësi prindërore” nënkupton autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme autoriteti që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë në lidhje me fëmijën ose pasurinë e tij (neni 1, pika 2). Masat e parashikuara nga Konventa përfshijnë, ndër të tjera, dhënien, ushtrimin, përfundimin ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore dhe të të drejtave të kujdestarisë (neni 3).

45. Në lidhje me juridiksionin, Konventa parashikon se autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës (neni 5, pika 1). Në rast ndryshimi të banesës së përhershme të fëmijës në një shtet tjetër kontraktues, juridiksioni u kalon autoriteteve të shtetit të banesës së re të përhershme (neni 5, pika 2). Për fëmijët emigrantë, fëmijët të cilët, për shkak të problemeve të ndodhura në vendin e tyre, janë zhvendosur në një shtet tjetër, si dhe për fëmijët banesa e përhershme e të cilëve nuk mund të përcaktohet, juridiksioni u përket autoriteteve të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ndodhen këta fëmijë (neni 6).

46. Në rast të largimit ose mbajtjes së gabuar të fëmijës, konventa parashikon se autoritetet e shtetit kontraktues në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm menjëherë para largimit ose mbajtjes ruajnë juridiksionin e tyre derisa fëmija të ketë marrë një banesë të përhershme në një shtet tjetër dhe të plotësohet një nga kushtet e parashikuara në nenin 7, pika 1, shkronjat “a” ose “b”. Sipas këtyre parashikimeve, juridiksioni i autoriteteve të shtetit të banesës së mëparshme të përhershme ruhet derisa çdo person, institucion ose organ tjetër që ka të drejta kujdestarie të ketë rënë dakord për largimin ose mbajtjen e fëmijës, ose derisa fëmija të ketë banuar në shtetin tjetër për një periudhë prej jo më pak se një vit pasi personi, institucioni ose organi tjetër që ka të drejta kujdestarie, ka ose duhet të ketë pasur dijeni për vendndodhjen e fëmijës, asnjë kërkesë për kthim e paraqitur brenda kësaj periudhe nuk është pezull (nuk është ende në shqyrtim), dhe fëmija është vendosur në ambientin e tij të ri.

47. Sipas nenit 7, pika 2, të Konventës, largimi ose mbajtja e fëmijës konsiderohen të gabuara kur shkelin të drejtat e kujdestarisë që i jepen një personi, institucioni ose organi tjetër, kolektivisht ose individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm menjëherë para largimit ose mbajtjes, dhe kur, në kohën e largimit ose mbajtjes,

këto të drejta ushtroheshin, kolektivisht ose individualisht, ose duhet të ishin ushtruar në këtë mënyrë, me përjashtim të largimit ose mbajtjes. Për sa kohë autoritetet e përmendura në nenin 7, pika 1, ruajnë juridiksionin e tyre, autoritetet e shtetit kontraktues tek i cili fëmija është larguar ose në të cilin është mbajtur mund të marrin vetëm ato masa urgjente që, sipas nenit 11, janë të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës (neni 7, pika 3).

48. Konventa parashikon, gjithashtu, mekanizma për transferimin ose marrjen e juridiksionit nga autoritetet e një shteti tjetër kontraktues, kur, në një rast të veçantë, vlerësohet se autoritetet e këtij shteti janë më mirë të vendosura për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës dhe për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse (nenet 8 dhe 9). Kështu, sipas nenit 8, autoriteti i shtetit kontraktues që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse gjykon se autoriteti i një shteti tjetër kontraktues do të ishte më mirë i vendosur në një rast të veçantë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës, mund të kërkojë që autoriteti tjetër të marrë juridiksionin për të ndërmarrë masat mbrojtëse që i gjykon të nevojshme ose të pezullojë shqyrtimin e çështjes dhe të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të atij shteti tjetër. Sipas nenit 9, autoritetet e një shteti kontraktues, të referuara në nenin 8, pika 2, nëse, në rastin e veçantë, gjykojnë se janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës, mund t'i kërkojnë autoritetit kompetent të shtetit kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës që të autorizohen për të ushtruar juridiksionin për marrjen e masave mbrojtëse që i gjykojnë të nevojshme ose të ftojnë palët të paraqesin një kërkesë të tillë para autoritetit të shtetit kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës.

49. Po sipas Konventës, pa paragjykuar dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një shteti kontraktues që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmije që është banor i përhershëm në një shtet tjetër kontraktues, ose për anulimin e martesës së tyre, mund të marrin masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, nëse këtë e lejon ligji i shtetit të tyre dhe nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 10, pika 1. Këto kushte janë: së pari, në kohën e fillimit të procedimit njëri nga prindërit të ketë banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri prej tyre të ketë përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën (shkronja "a"); së dyti, juridiksioni i këtyre autoriteteve për marrjen e masave në lidhje me mbrojtjen e fëmijës të jetë pranuar nga prindërit dhe nga çdo person tjetër që ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën, si dhe kjo të jetë në interesin më të mirë të fëmijës (shkronja "b"). Sipas nenit 10, pika 2, juridiksioni për marrjen e këtyre masave ndërpritet nëse vendimi për të lejuar ose refuzuar kërkesën për divorc, ndarjen ligjore ose prishjen e martesës ka marrë formë të prerë ose procedimi ka përfunduar për ndonjë arsye tjetër.

50. Përveç sa më sipër, Konventa parashikon juridiksionin e autoriteteve të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ndodhet fëmija për marrjen e masave të nevojshme mbrojtëse në rastet emergjente (neni 11). Po ashtu, duke mbajtur parasysh parashikimet e nenit 7, autoritetet e një shteti kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, kanë juridiksion për të marrë masa me karakter të përkohshëm për mbrojtjen e fëmijës, me efekt territorial të kufizuar në shtetin në fjalë, për sa kohë këto masa nuk janë në mospërputhje me masat e marra tashmë nga autoritetet që kanë juridiksion sipas neneve 5-10 (neni 12, pika 1). Masat e përkohshme të marra në lidhje me një fëmijë që është banor i përhershëm në një shtet kontraktues shfuqizohen nëse autoritetet që kanë juridiksion sipas neneve 5-10 kanë marrë një vendim në lidhje me masat mbrojtëse që mund të kërkohen sipas rrethanave (neni 12, pika 2). Ndërsa masat e marra në lidhje me një fëmijë që është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues shfuqizohen në shtetin kontraktues ku janë marrë, nëse masat e kërkuara nga rrethanat dhe të marra nga autoritetet e një shteti tjetër janë njohur në shtetin kontraktues në fjalë (neni 12, pika 3).

51. Në lidhje me rastet kur masa korresponduese për mbrojtjen e fëmijës janë kërkuar në më shumë se një shtet kontraktues, neni 13 i Konventës parashikon se autoritetet e një shteti kontraktues, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10 për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, duhet të frenohen nga ushtrimi i këtij juridiksioni, nëse, në kohën e fillimit të procedimit, masa korresponduese janë kërkuar nga autoritetet e një shteti tjetër kontraktues që ka juridiksion sipas neneve 5-10 në kohën e kërkesës dhe janë akoma në proces shqyrtimi (neni 13, pika 1). Ky rregull nuk zbatohet nëse autoritetet para të cilave është paraqitur fillimisht kërkesa për marrjen e masave nuk kanë juridiksion (neni 13, pika 2).

52. Në dritën e këtij kuadri normativ, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse gjykatat e zakonshme, në vendimmarrjet e kundërshtuara, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në këtë drejtim, pa zëvendësuar gjykatat e zakonshme në interpretimin dhe zbatimin e ligjit të zbatueshëm, Gjykata do të verifikojë nëse ato kanë identifikuar qartë kuadrin ligjor përkatës, kanë dhënë arsye të mjaftueshme për zbatimin e tij në rrethanat e çështjes dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuar në lidhje me marrëdhënien ndërmjet rregullave të KF-së për pasojat e zgjidhjes së martesës, rregullave të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private për juridiksionin në çështjet familjare me elemente të huaja dhe dispozitave të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore që lidhen me përcaktimin e juridiksionit, si dhe pretendimit se pranimi i juridiksionit shqiptar kërkohej nga interesi më i lartë i fëmijës. Po ashtu, Gjykata do të verifikojë nëse interpretimi dhe arsyetimi

i vendimeve të kundërshtuara paraqesin gabime ligjore ose faktike të dukshme, paqartësi ose elemente arbitrariteti që janë të një shkalle të tillë sa të cenojnë të drejtën e aksesit në gjykatë.

53. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkesja, në datën 05.08.2022 ka vënë në lëvizje gjykatën e shkallës së parë me padi për zgjidhjen e martesës dhe lënien e fëmijës asaj për rritje dhe edukim. Ndërkohë, në procesin për kthimin e fëmijës në Belgjikë, gjykatat shqiptare kishin vendosur kthimin e fëmijës në vendbanimin e tij të përhershëm në Belgjikë, vendimmarrje e cila ishte bërë përfundimtare pas vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të kërkuës. Po ashtu, përpara gjykatës belge ishte vënë në lëvizje një proces për zgjidhjen e martesës dhe kujdestarinë e fëmijës, në të cilin gjykata belge, me vendimin e datës 25.10.2022, i kishte njohur përkohësisht subjektit të interesuar të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke vlerësuar se kishte juridiksion për shqyrtimin e çështjes, bazuar, ndër të tjera, në nenet 5 dhe 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore dhe në faktin se fëmija kishte vendqëndrimin e zakonshëm në Belgjikë.

54. Gjatë vijimit të gjykimit të çështjes në Shqipëri për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën, subjekti i interesuar ka kërkuar që kërkitimi që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të nxirrej jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar. Ai ka pretenduar se çështja kishte elemente të huaja, për shkak të shtetësisë së tij belge, vendit të lidhjes së martesës, vendqëndrimit të zakonshëm të bashkëshortëve dhe të fëmijës në Belgjikë, lindjes dhe shtetësisë belge të fëmijës, si dhe faktit se në Belgjikë po zhvillohej një proces gjyqësor me të njëjtin objekt.

55. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 18.09.2024, ka pranuar kërkitimin për zgjidhjen e martesës, ndërsa ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar kërkitimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në mënyrë të përmblodhur, ajo ka arsyetuar se në kushtet kur me vendim gjyqësor përfundimtar ishte vendosur kthimi i fëmijës në vendbanimin e tij të përhershëm në Belgjikë, bazuar në nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, në Ligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe në nenin 59 të KPC-së, gjykatat shqiptare nuk kishin juridiksion për shqyrtimin e këtij kërkitimi.

56. Kërkesja nuk ka qenë dakord me vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pjesën që kishte vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërkitimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke ushtruar rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë. Në rekurs kërkesja ka pretenduar, në thelb, se për sa kohë gjykata shqiptare kishte pranuar juridiksionin për zgjidhjen e martesës, ajo kishte juridiksion edhe për rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën, referuar nenit 226 të KF-së. Po ashtu, kërkesja ka pretenduar se juridiksioni i gjykatave shqiptare buronte edhe nga neni 76 i Ligjit për të Drejtën

Ndërkombëtare Private, për sa kohë ajo kishte shtetësinë shqiptare dhe vendqëndrimin e zakonshëm në Shqipëri. Sipas saj, neni 5 i Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, i referuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk ishte detyrues për gjykatën që kishte juridiksion për zgjidhjen e martesës, ndërsa vendimi për nxjerrjen e kërimit jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar binte në kundërshtim me nenin 13 të kësaj konvente, për shkak të procesit të nisur më parë përpara gjykatave shqiptare. Kërkesja ka pretenduar, gjithashtu, se deri në ekzekutimin e vendimit për kthimin e fëmijës në Belgjikë, gjykata shqiptare kishte juridiksion për të vendosur për këtë kërkim. Sipas saj, nxjerrja e kërimit jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar e kishte lënë të pazgjidhur mosmarrëveshjen për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës, i cili kishte shtetësi shqiptare dhe qëndronte në Shqipëri prej disa vitesh.

57. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka paraqitur kundërrekurs, duke kundërshtuar pretendimet e ngritura në rekursin e kërkeses. Sipas tij, kërkesja nuk kishte zbatuar vendimet gjyqësore për kthimin e fëmijës në banesën e përhershme në Belgjikë dhe vazhdonte ta mbante atë në Shqipëri në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me vendimet e gjykatave shqiptare dhe belge. Ai ka prapësuar se pretendimet e kërkeses për zbatimin e dispozitave të KF-së ishin të pabazuara, pasi, në rastin konkret, për shkak të elementeve të huaja të marrëdhënies juridike, duhej të zbatoheshin dispozitat konventore dhe ato të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Në këtë drejtim, subjekti i interesuar ka theksuar se martesa ishte lidhur në Belgjikë, fëmija kishte lindur dhe kishte vendqëndrimin e përhershëm në Belgjikë, ndërsa regjistrimi i tij në Shqipëri nuk mund të ndryshonte vendbanimin e tij të përhershëm dhe as të përcaktonte juridiksionin e gjykatave shqiptare. Po ashtu, ai ka parashtruar se gjykatat belge, me vendimet e datave 25.10.2022 dhe 04.04.2023, i kishin njohur ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror, ndërsa mbajtja e fëmijës nga kërkesja në Shqipëri cenonte të drejtën e tij të kujdestarisë dhe interesin më të lartë të fëmijës. Për këto arsye, subjekti i interesuar ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

58. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 23.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në pjesën që ka disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Ai ka theksuar se verifikimi i juridiksionit gjyqësor është parakusht për vijimin e gjyqësorisë. Në këtë drejtim, Kolegji Civil ka pranuar se konstatimi i mungesës së juridiksionit në përfundim të procesit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë nuk ishte në përputhje me përcaktimet ligjore lidhur me momentin e verifikimit të juridiksionit nga gjykata. Megjithatë, ai ka çmuar se, duke qenë se mungesa e juridiksionit e bën vendimin

gjyqësor jo të rregullt, kjo rrethanë nuk passillte cenimin e disponimit të gjykatës së shkallës së parë.

59. Në vijim, në lidhje me përcaktimin e juridiksionit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar, fillimisht, se çështja paraqiste një marrëdhënie juridike me elemente të huaja, për shkak të shtetësisë shqiptare të kërkueses, shtetësisë belge të subjektit të interesuar, shtetësisë shqiptare dhe belge të fëmijës, si dhe vendqëndrimit të përhershëm të subjektit të interesuar në Belgjikë. Në këtë kuadër, duke iu referuar nenit 37, pika 2, të KPC-së, Kolegji Civil ka theksuar se, në rastet e marrëdhënieve me elemente të huaja, juridiksioni i gjykatave shqiptare përcaktohet sipas ligjit të posaçëm dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Mbi këtë bazë, ai ka identifikuar Ligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili, sipas tij, përcakton juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile me elemente të huaja, duke përcaktuar rastet e juridiksionit alternativ dhe ekskluziv, si dhe rregullat për shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve juridiksionale. Po në këtë kuadër, Kolegji Civil ka vlerësuar si të zbatueshme edhe Konventën për Përgjegjësinë Prindërore, si marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar që përcakton juridiksionin për marrjen e masave në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, përfshirë ato që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

60. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka evidentuar se pretendimet e kërkueses për juridiksionin e gjykatave shqiptare mbështeteshin, në thelb, në dy drejtime: së pari, në faktin se fëmija ndodhej prej disa vitesh në Shqipëri, kishte shtetësi shqiptare dhe, sipas saj, vendqëndrim në Shqipëri, ndaj juridiksioni i gjykatave shqiptare duhej të pranohej edhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës; së dyti, në pretendimin se, sipas KF-së, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore është pjesë e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës dhe, për rrjedhojë, gjykata që kishte vendosur për zgjidhjen e martesës duhet të kishte disponuar edhe për këtë pasojë. Në vijim, Kolegji Civil ka mbajtur parasysh se, në rastin konkret, kërkuësja kishte jetuar së bashku me subjektin e interesuar dhe fëmijën në Belgjikë, se më pas ishte kthyer me fëmijën në Shqipëri, se Gjykata e Shkallës së Parë e Anversës, Belgjikë, me vendimin e datës 25.10.2022, kishte vendosur ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror nga babai, si dhe se gjykatat shqiptare, në procedurën për kthimin e fëmijës sipas Konventës për Rrëmbimin e Fëmijës, kishin urdhëruar kthimin e fëmijës në Belgjikë, duke e konsideruar mbajtjen e tij në Shqipëri si të paligjshme.

61. Në drejtim të kuadrit ligjor të zbatueshëm, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shtruar në vijim si çështje përcaktuese nëse vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës duhej të vlerësohej sipas gjendjes faktike të krijuar nga qëndrimi i tij në Shqipëri apo në raport me

përcaktimet konventore për largimin ose mbajtjen pa të drejtë të fëmijës. Për këtë qëllim, ai i është referuar neneve 5 dhe 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, si dhe dispozitave të KC-së dhe Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private për konceptet e vendbanimit dhe vendqëndrimit të zakonshëm. Kolegji Civil ka arsyetuar se, sipas nenit 5, autoritetet e shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme kanë juridiksion për marrjen e masave për mbrojtjen e tij, ndërsa, sipas nenit 7, në rast largimi ose mbajtjeje pa të drejtë të fëmijës, autoritetet e shtetit ku fëmija ka qenë banor i përhershëm menjëherë para largimit ose mbajtjes ruajnë juridiksionin e tyre. Sipas Kolegjit Civil, koncepti i vendqëndrimit të zakonshëm është çështje fakti, që vlerësohet rast pas rasti, por nuk mund të interpretohet në raport me një gjendje faktike paligjshmërie, për sa kohë neni 7 i konventës e përjashton këtë situatë në përcaktimin e juridiksionit të shtetit ku fëmija mbahet në mënyrë të padrejtë. Mbi këtë bazë, duke mbajtur parasysh vendimet për kthimin e fëmijës në Belgjikë dhe vendimin e gjykatës belge për ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror nga babai, Kolegji Civil ka çmuar se vetëm qëndrimi faktik i fëmijës në Shqipëri dhe regjistrimi i tij me shtetësi ose vendbanim shqiptar nuk mjaftojnë për të përcaktuar juridiksionin e gjykatave shqiptare për këtë kërkim.

62. Në të njëjtën linjë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se, në kuadër të vendimit për ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror nga babai dhe vendimeve gjyqësore për kthimin e fëmijës në Belgjikë, nuk mund të pretendohet se vetëm për shkak të qëndrimit faktik të fëmijës në Shqipëri, si situatë joligjore, të përcaktohet juridiksioni i gjykatave shqiptare. Po sipas tij, gjykatat kishin vlerësuar, në raport me interesin më të lartë të fëmijës, se ushtrimi i përkohshëm i autoritetit prindëror i ishte njohur babait dhe se fëmija duhej të kthehej në vendbanimin e tij të përhershëm në Belgjikë, ndaj ky interes nuk mund të vlerësohet ndryshe vetëm mbi faktin e qëndrimit të fëmijës në Shqipëri, si pasojë e vendimmarrjes së njërit prej prindërve.

63. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është shprehur edhe për marrëdhënien ndërmjet disponimit të gjykatës së shkallës së parë për zgjidhjen e martesës dhe nxjerrjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në këtë drejtim, ai ka vlerësuar se, në kushtet kur në rastin konkret ekzistonte një vendim i përkohshëm për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijën, gjykimi i këtij kërkit sipas juridiksionit të vendbanimit të fëmijës nuk cenonte efektet e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë. Në përfundim, Kolegji Civil ka vlerësuar se, në referim të nenit 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, gjykatat shqiptare nuk kishin juridiksion për këtë kërkim, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë në këtë pjesë.

64. Nga sa më lart, Gjykata vëren se pretendimi kryesor i kërkueses lidhet me faktin se gjykatat e zakonshme, duke nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për marrëdhënien ndërmjet rregullave të KF-së për pasojat e zgjidhjes së martesës, rregullave të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private për juridiksionin në çështjet familjare me elemente të huaja dhe dispozitave të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore që lidhen me përcaktimin e juridiksionit. Sipas kërkueses, për sa kohë gjykata shqiptare kishte pranuar juridiksionin për zgjidhjen e martesës, ajo duhej të vendoste edhe për rregullimin e pasojave të saj në lidhje me fëmijën. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, se përcaktimi i juridiksionit duhej të mbështetej edhe në interesin më të lartë të fëmijës, duke parashtruar se qëndrimi i tij në Shqipëri, shtetësia shqiptare dhe lidhjet e krijuara me këtë vend duhej të merreshin parasysh në këtë drejtim.

65. Në këtë kuadër, Gjykata çmon se vlerësimi i këtij pretendimi duhet të bëhet duke mbajtur parasysh natyrën e vendimmarrjeve të kundërshtuara, përmes të cilave nuk është zgjidhur në themel mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por është përcaktuar se ky kërkim nuk përfshihej në juridiksionin gjyqësor shqiptar. Për këtë arsye, kontrolli kushtetues në rastin konkret kufizohet në verifikimin nëse gjykatat e zakonshme kanë dhënë arsye të mjaftueshme për këtë përfundim dhe nëse ky përfundim paraqet gabime ligjore ose faktike të dukshme, paqartësi ose elemente arbitrariteti të një shkalle të tillë sa të cenojë të drejtën e aksesit në gjykatë.

66. Po ashtu, Gjykata çmon të theksojë se ndonëse objekt i shqyrtimit në rastin konkret nuk është mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por përcaktimi i juridiksionit për shqyrtimin e këtij kërrimi, analiza duhet të mbajë parasysh edhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të garantuar nga neni 54 i Kushtetutës dhe të reflektuar në legjislacionin e brendshëm dhe në instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme. Në çështjet familjare me elemente të huaja, ky parim nuk vepron si kriter autonom dhe as mund të zbatohet i shkëputur nga rregullat e juridiksionit që përcaktojnë autoritetin kompetent. Për rrjedhojë, kontrolli kushtetues në rastin konkret nuk konsiston në rivlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës në raport me mënyrën konkrete të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por në verifikimin nëse gjykatat e zakonshme kanë identifikuar, interpretuar dhe zbatuar pa arbitraritet rregullat e juridiksionit, në një mënyrë të pajtueshme me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

67. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, pasi ka pranuar kërkimin për zgjidhjen e martesës, ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Ajo ka arsyetuar se

çështja paraqiste elemente të huaja dhe se, për sa i përket përgjegjësisë prindërore, duhej të mbaheshin parasysh Konventa për Përgjegjësinë Prindërore, Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe fakti se gjykatat shqiptare kishin urdhëruar kthimin e fëmijës në Belgjikë, si vendbanim i tij i përhershëm. Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë e ka lidhur mungesën e juridiksionit shqiptar me vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës dhe me rregullat e konventës që përcaktojnë juridiksionin për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë ato që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

68. Po ashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk është kufizuar në një miratim formal të arsytimit të gjykatës së shkallës së parë, por ka identifikuar pretendimet kryesore të kërkueses për juridiksionin e gjykatave shqiptare. Konkretisht, ajo ka evidentuar se këto pretendime ngriheshin në dy drejtime: së pari, në faktin se fëmija ndodhej prej disa vitesh në Shqipëri, kishte shtetësi shqiptare dhe, sipas kërkueses, vendqëndrim në Shqipëri, ndaj juridiksioni i gjykatave shqiptare duhej të pranohej edhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës; së dyti, në pretendimin se, sipas KF-së, përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është pjesë e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës dhe, për rrjedhojë, gjykata që vendos për zgjidhjen e martesës duhet të disponojë edhe për pasojat e saj në lidhje me fëmijën. Në vijim, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim marrëdhënien ndërmjet qëndrimit faktik të fëmijës në Shqipëri dhe përcaktimit të juridiksionit sipas Konventës për Përgjegjësinë Prindërore. Në këtë aspekt, ajo ka vlerësuar se, për sa kohë në procedurën e kthimit të fëmijës ishte vendosur kthimi i tij në Belgjikë dhe largimi ose mbajtja e tij në Shqipëri ishte konsideruar e paligjshme, gjendja faktike e krijuar nga qëndrimi i fëmijës në Shqipëri nuk mund të shërbente, në vetvete, për të përcaktuar Shqipërinë si vendqëndrim të zakonshëm të fëmijës për qëllime të juridiksionit. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë e ka lidhur përfundimin për mungesën e juridiksionit shqiptar me nenin 7 të Konventës, vendimet për kthimin e fëmijës në Belgjikë dhe vendimin e përkohshëm të gjykatës belge për ushtrimin e autoritetit prindëror, duke çmuar se interesi më i lartë i fëmijës nuk mund të vlerësohej vetëm mbi bazën e qëndrimit të tij faktik në Shqipëri.

69. Nga sa më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës së Lartë, në respektim të parimit të hierarkisë së akteve, është mbështetur kryesisht te nenet 5 dhe 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore. Në këtë drejtim, për të verifikuar nëse ky arsyetim dhe përfundimi i saj mbartin elemente arbitrariteti, Gjykata mban parasysh se neni 5 i kësaj konvente përcakton rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme kanë juridiksion për marrjen e masave për mbrojtjen e tij. Në rast të ndryshimit të banesës së përhershme të fëmijës në një shtet tjetër

kontraktues, juridiksioni u kalon autoriteteve të shtetit të banesës së re të përhershme, përveç rastit kur gjen zbatim neni 7 i konventës. Nga ana tjetër, neni 7 parashikon rregullin e posaçëm për rastet e largimit ose mbajtjes pa të drejtë të fëmijës. Sipas kësaj dispozite, autoritetet e shtetit kontraktues në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm menjëherë para largimit ose mbajtjes ruajnë juridiksionin e tyre derisa fëmija të ketë marrë një banesë të përhershme në një shtet tjetër dhe të plotësohen kushtet e parashikuara në këtë nen. Këto kushte lidhen, në mënyrë alternative, ose me pranimin e largimit ose mbajtjes së fëmijës nga personi, institucioni ose organi që ka të drejta kujdestarie, ose, në mungesë të këtij pranimi, me qëndrimin e fëmijës për të paktën një vit pasi personi përkatës ka pasur ose duhet të kishte pasur dijeni për vendndodhjen e tij, mungesën e një kërkesë për kthim ende në shqyrtim dhe integrimin e fëmijës në mjedisin e ri.

70. Po në këtë funksion, Gjykata mban parasysh edhe Raportin Shpjegues të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore të hartuar nga Paul Lagarde, raportuesi zyrtar i Konventës. Ky raport nuk është pjesë e tekstit të konventës dhe nuk ka karakter detyrues normativ, por konsiderohet pjesë e punimeve përgatitore të saj (*travaux préparatoires*) dhe përbën një nga mjetet më autoritative për interpretimin e dispozitave të Konventës, pasi shpjegon qëllimin, përmbajtjen dhe kompromiset që kanë shoqëruar hartimin e tyre. Konkretisht, Raporti Shpjegues sqaron se rregullat e juridiksionit synojnë, si rregull, përqendrimin e juridiksionit tek autoritetet e shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës dhe shmangien, sa të jetë e mundur, e konkurrencës së autoriteteve që mund të pretendojnë juridiksion (*shih Raportin Shpjegues, paragrafi 37*). Po sipas Raportit Shpjegues, neni 7 mbështetet në idenë themelore se personi që kryen largimin ose mbajtjen pa të drejtë të fëmijës nuk duhet të jetë në gjendje të përfitojë nga ky veprim për të ndryshuar, në dobi të tij, juridiksionin e autoriteteve që duhet të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës. Në të njëjtën kohë, raporti sqaron se kur largimi ose mbajtja pa të drejtë vazhdon në kohë, kjo është një rrethanë faktike që nuk mund të injorohet plotësisht, ndaj neni 7 përcakton prapë në të cilin juridiksioni mund të kalojë tek autoritetet e shtetit ku fëmija është larguar ose mbahet (*shih Raportin Shpjegues, paragrafi 46*). Për këtë arsye, kohëzgjatja e qëndrimit faktik të fëmijës në atë shtet nuk është, në vetvete, rrethanë përcaktuese për juridiksionin sipas Konventës. Raporti Shpjegues thekson se për humbjen e juridiksionit nga autoritetet e shtetit të vendqëndrimit të mëparshëm të zakonshëm, nuk mjafton vetëm që fëmija të ketë fituar një vendqëndrim të zakonshëm në një shtet tjetër, por duhet të plotësohen edhe kushtet e tjera të nenit 7 (*shih Raportin Shpjegues, paragrafi 47*). Në mungesë të pranimin të largimit ose mbajtjes, këto kushte përfshijnë qëndrimin e fëmijës në shtetin e vendqëndrimit të ri të zakonshëm për të paktën një vit pasi mbajtësi i të drejtave të kujdestarisë

ka pasur ose duhet të kishte pasur dijeni për vendndodhjen e tij, mungesën e një kërkesë për kthim ende në shqyrtim dhe integrimin e fëmijës në mjedisin e ri (*shih paragrafin 49 të Raportit*). Kjo qasje pasqyron parimin e afërsisë (*principle of proximity*), sipas të cilit juridiksioni u njihet, si rregull, autoriteteve që kanë lidhjen më të afërt me mjedisin familjar dhe shoqëror të fëmijës, në funksion të mbrojtjes së interesit të tij më të lartë dhe shmangies së konkurrencës ndërmjet autoriteteve.

71. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesja i është referuar kohëzgjatjes së qëndrimit të fëmijës në Shqipëri për të mbështetur pretendimin për juridiksionin gjyqësor shqiptar. Megjithatë, kjo rrethanë nuk mund të vlerësohet e shkëputur, por në raport me kushtet e nenit 7 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore dhe me rrethanat konkrete të çështjes. Në këtë kontekst, nuk rezulton që subjekti i interesuar të ketë pranuar largimin ose mbajtjen e fëmijës nga kërkesja në Shqipëri. Përkundrazi, ai ka kërkuar kthimin e fëmijës në Belgjikë brenda 6 ditëve nga momenti kur është vënë në dijeni për vendimin e kërkuësës për mbajtjen e fëmijës në Shqipëri dhe moskthimin e tij në vendqëndrimin e zakonshëm familjar në Belgjikë. Po ashtu, gjykatat shqiptare, në procedurën e kthimit, kanë urdhëruar kthimin e fëmijës në Belgjikë, vendimmarrje që ka qenë e ekzekutueshme brenda më pak se 7 muajve nga vënia në lëvizje e procedurës së kthimit. Për rrjedhojë, kohëzgjatja faktike e qëndrimit të fëmijës në Shqipëri, së cilës kërkesja i referohet, lidhet me pasojat e një situate të vlerësuar gjyqësisht si mbajtje pa të drejtë e fëmijës dhe të zgjatur për shkak të mosekzekutimit në kohë të vendimit për kthimin e tij. Në raport me nenin 7 të Konventës, kjo kohëzgjatje nuk mund të lexohet e shkëputur nga fakti se procedura e kthimit ishte vënë në lëvizje në kohë dhe se kishte një vendimmarrje gjyqësore për kthimin e fëmijës në Belgjikë. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuësës në drejtim të qëndrimit faktik të fëmijës në Shqipëri, shtetësisë shqiptare dhe regjistrimit të tij në këtë shtet nuk tregon se në arsyetimin e Gjykatës së Lartë ka ndonjë gabim ligjor ose faktik të dukshëm dhe as nuk e bën haptazi arbitrar përfundimin e saj se këto rrethana nuk ishin të mjaftueshme për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare.

72. Për sa i përket pretendimit të kërkuësës se neni 226 i KF-së i detyron gjykatat shqiptare që, në rastin e zgjidhjes së martesës, të vendosin edhe për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, Gjykata çmon se ky pretendim ka marrë përgjigje në substancë nga gjykatat e zakonshme. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka evidentuar se kërkesja e mbështeste juridiksionin shqiptar edhe në faktin se gjykata shqiptare kishte vendosur për zgjidhjen e martesës dhe se, sipas saj, duhej të dispononte edhe për pasojat e saj në lidhje me fëmijën. Megjithatë, duke iu referuar elementeve të huaja të çështjes dhe rregullave të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar këtë pretendim si të mjaftueshëm

për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare për këtë kërkim. Në këtë mënyrë, arsyetimi i saj është ndërtuar mbi dallimin ndërmjet rregullave të brendshme që përcaktojnë pasojat e zgjidhjes së martesës dhe rregullave të posaçme që përcaktojnë juridiksionin për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë ato që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore në marrëdhëniet me elemente të huaja.

73. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se dispozita e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore që lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e gjykatës së divorcit është neni 10. Në funksion të kontrollit nëse përfundimi i Gjykatës së Lartë është haptazi arbitrar, Gjykata mban parasysh se kjo dispozitë nuk e parashikon juridiksionin e gjykatës së divorcit si pasojë automatike të juridiksionit për zgjidhjen e martesës, por e kushtëzon atë me plotësimin e kushteve të përcaktuara në të, ndër të cilat edhe pranimi i këtij juridiksioni nga prindërit dhe çdo person tjetër që ka përgjegjësi prindërore, si dhe vlerësimi se ushtrimi i tij është në interesin më të mirë të fëmijës. Në këtë drejtim, Raporti Shpjegues i Konventës sqaron se juridiksioni i gjykatës së divorcit për të marrë masa mbrojtëse për fëmijën nuk është i detyrueshëm për atë gjykatë, por njihet vetëm kur këtë e lejon ligji i brendshëm dhe kur plotësohen kushtet e nenit 10, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të cilat janë kumulative (*shih Raportin Shpjegues, paragrafët 62 dhe 64*). Po sipas raportit, teksti i konventës nuk kërkon dakordësinë e prindërve për masat që duhen marrë, por pranimin e juridiksionit, ndërsa nëse një ose më shumë nga këto kushte nuk përmbushen, gjykata e divorcit nuk ka juridiksion për të marrë masa mbrojtëse për fëmijën, përveç rastit kur përfiton nga transferimi i juridiksionit sipas neneve 8 dhe 9 të konventës (*shih Raportin Shpjegues, paragrafin 65*).

74. Në rastin konkret, nga rrethanat e çështjes rezulton se subjekti i interesuar e ka kundërshtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare për kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ka kërkuar nxjerrjen e këtij kërkit jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës se juridiksioni i gjykatës shqiptare për zgjidhjen e martesës duhej të shtrihej domosdoshmërisht edhe mbi këtë kërkim nuk gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në nenin 10 të konventës, për sa kohë kjo dispozitë kërkon, ndër të tjera, pranimin e juridiksionit, në veçanti nga prindërit, për marrjen e masave në lidhje me mbrojtjen e fëmijës. Po ashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekurs të veçantë vetëm për pjesën e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që kishte nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar kërkimin që lidhej me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ndërkohë që disponimi për zgjidhjen e martesës, në mungesë të ankimit nga palët, kishte marrë formë të prerë. Kjo rrethanë merr rëndësi edhe në raport me nenin 10, pika 2, të konventës, për të cilin Raporti Shpjegues sqaron se juridiksioni i gjykatës së divorcit për të marrë masa

mbrojtëse për fëmijën pushon kur procedura e divorcit përfundon, ndërsa pas këtij momenti vetëm autoriteti që ka juridiksion sipas neneve 5-9 të konventës mund të vendosë për këto masa (*shih Raportin Shpjegues, paragrafin 66*). Në këtë kontekst, pretendimi se juridiksioni i pranuar për zgjidhjen e martesës duhej të sillte domosdoshmërisht edhe juridiksionin për kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nuk evidenton një gabim ligjor të dukshëm në interpretimin e kuadrit konventor dhe as nuk e bën të pamjaftueshëm arsyetimin e Gjykatës së Lartë ose haptazi arbitrar përfundimin e saj, për sa kohë ajo e ka vlerësuar këtë kërkim në raport me rregullat e posaçme të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore.

75. Për sa i përket pretendimit të kërkuësës për nenin 13 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, Gjykata vëren se ai lidhet me faktin se procesi për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj ishte vënë fillimisht në lëvizje përpara gjykatës shqiptare. Megjithatë, në funksion të verifikimit të arsyetimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata mban parasysht se neni 13 i Konventës nuk vendos një rregull përparësie formale në favor të autoritetit që është vënë i pari në lëvizje, pavarësisht nëse ai ka juridiksion sipas konventës. Kjo dispozitë vepron në rastet kur masat korresponduese janë kërkuar përpara autoriteteve të një shteti tjetër kontraktues që kanë juridiksion sipas neneve 5-10 të konventës dhe janë ende në shqyrtim. Në këtë drejtim, Raporti Shpjegues sqaron se neni 13 synon të trajtojë konfliktet që mund të lindin nga ekzistenca e juridiksioneve të njëkohshme sipas konventës dhe të shmangë rrezikun e vendimeve kontradiktore (*shih Raportin Shpjegues, paragrafi 78*). Po sipas raportit, autoriteti që ka juridiksion sipas neneve 5-10 duhet të përmbahet nga vendimmarrja mbi kërkesën për masa, nëse masa të njëjta u janë kërkuar autoriteteve të një shteti tjetër kontraktues, të cilat në atë kohë kishin juridiksion po sipas të njëjtave dispozita dhe këto masa janë ende në shqyrtim (*shih Raportin Shpjegues, paragrafi 79*). Për më tepër, vetë pika 2 e nenit 13 parashikon se rregulli i frenimit nga ushtrimi i juridiksionit nuk zbatohet nëse autoritetet para të cilave është paraqitur fillimisht kërkesa nuk kanë juridiksion. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuësës se procedura ishte nisur më parë përpara gjykatës shqiptare nuk mjafton, në vetvete, për ta bërë haptazi arbitrar përfundimin e Gjykatës së Lartë se juridiksioni për këtë kërkim nuk u përkiste gjykatave shqiptare, për sa kohë ky përfundim është mbështetur në rregullat e neneve 5 dhe 7 të Konventës. Për rrjedhojë, mungesa e një analize të veçantë për nenin 13 nuk evidenton, në rrethanat e rastit konkret, një mangësi të tillë në arsyetimin e Gjykatës së Lartë që ta bëjë atë të pamjaftueshëm ose përfundimin e saj haptazi arbitrar, për sa kohë ajo ka dhënë arsye për mungesën e juridiksionit shqiptar në raport me rregullat e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore që i ka konsideruar përcaktuese.

76. Në lidhje me pretendimet e kërkuases për nenet 75 dhe 76 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, ndonëse nuk ka zhvilluar një analizë të veçantë për secilën prej këtyre dispozitave, e ka identifikuar këtë ligj si pjesë të kuadrit të zbatueshëm për përcaktimin e juridiksionit në marrëdhëniet juridike civile me elemente të huaja. Ajo ka vlerësuar se çështja paraqiste elemente të huaja dhe se, në raste të tilla, juridiksioni i gjykatave shqiptare përcaktohet sipas ligjit të posaçëm dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private përcakton rastet e juridiksionit alternativ dhe ekskluziv, si dhe rregullat për shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve juridiksionale. Në këtë kontekst, duke zbatuar rregullat e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, si marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar që sipas nenit 122 të Kushtetutës dhe nenit 2 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private ka epërsi ndaj ligjit të brendshëm në rast mospajtimi, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar se kërkitimi që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore përfshihej në juridiksionin gjyqësor shqiptar. Nga ana tjetër, kërkuësja nuk ka argumentuar se çështjet familjare me elemente të huaja dhe, në veçanti, kërkitimi që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, përfshihen në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuases se nenet 75 dhe 76 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private çonin në pranimin e juridiksionit shqiptar nuk evidenton një gabim ligjor të dukshëm në interpretimin e kuadrit normativ dhe as nuk e bën, në vetvete, të pamjaftueshëm arsyetimin e Gjykatës së Lartë ose haptazi arbitrar përfundimin e saj.

77. Pas shqyrtimit të pretendimeve që lidhen me rregullat e posaçme të juridiksionit, Gjykata çmon të ndalet edhe në mënyrën sesi këto rregulla ndërveprojnë me parimin e interesit më të lartë të fëmijës në rastin konkret. Lidhur me këtë, Gjykata e Lartë ka mbajtur parasysh vendimet gjyqësore për kthimin e fëmijës në Belgjikë, faktin se mbajtja e tij në Shqipëri ishte vlerësuar si e padrejtë dhe vendimin e përkohshëm të gjykatës belge për ushtrimin e autoritetit prindëror nga babai i fëmijës. Ajo ka vlerësuar se interesi më i lartë i fëmijës nuk mund të vlerësohej ndryshe vetëm mbi bazën e qëndrimit faktik të tij në Shqipëri, të krijuar si pasojë e mbajtjes pa të drejtë të fëmijës, si dhe të shtetësisë shqiptare dhe të lidhjeve të krijuara gjatë kësaj periudhe. Gjykata vëren se ky arsyetim nuk e barazon vendimin për kthimin me një zgjidhje përfundimtare të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por i konsideron këto vendimmarrje si rrethana relevante për përcaktimin e autoritetit që, sipas rregullave konventore, ka juridiksion për ta bërë këtë vlerësim në themel. Në të njëjtin kuadër, Gjykata vëren se edhe argumenti i kërkuases i mbështetur në aktin e ekspertimit psikologjik nuk është i tillë që të vërë në dyshim këtë përfundim. Ky akt lidhet me vlerësimin në themel të mënyrës

së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe të marrëdhënies së fëmijës me prindërit, por nuk ka pasur për objekt përcaktimin e juridiksionit. Për rrjedhojë, përfundimet e tij mund të jenë objekt vlerësimi nga autoriteti kompetent gjatë shqyrtimit në themel, por nuk janë, në vetvete, përcaktuese për juridiksionin sipas konventës. Për këto arsye, pretendimi i kërkueses se interesi më i lartë i fëmijës dhe akti i ekspertimit kërkonin domosdoshmërisht shqyrtimin e kërimit nga gjykatat shqiptare nuk evidenton ndonjë gabim faktik të dukshëm në përcaktimin e juridiksionit, për sa kohë akti i ekspertimit lidhet me zgjidhjen në themel të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe jo me elementet juridike dhe faktike përcaktuese të juridiksionit. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mjafton për ta bërë të pamjaftueshëm arsyetimin e Gjykatës së Lartë ose haptazi arbitrar përfundimin e saj.

78. Në përfundim, Gjykata çmon se vendimmarrjet e kundërshtuara kanë identifikuar çështjen thelbësore të juridiksionit, kanë marrë parasysh rrethanat përcaktuese të rastit, përfshirë elementet e huaja të marrëdhënies juridike, vendimmarrjet gjyqësore për kthimin e fëmijës në Belgjikë, vendimin e gjykatës belge për ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror dhe dispozitat e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, si dhe kanë dhënë arsye të mjaftueshme për përfundimin se kërkitimi që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nuk përfshihej në juridiksionin gjyqësor shqiptar. Fakti që kërkuësja nuk pajtohet me interpretimin e këtyre dispozitave nga gjykatat e zakonshme nuk mjafton për të vënë në dyshim standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara. Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues nuk synon të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, përveç rasteve kur interpretimi i dhënë prej tyre, i pasqyruar në arsyetimin e vendimit, rezulton haptazi arbitrar ose kur arsyetimi është i paqartë ose i pamjaftueshëm në atë masë sa të cenojë të drejtën e aksesit në gjykatë. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se vendimmarrjet e kundërshtuara nuk paraqesin gabime ligjore ose faktike të dukshme, paqartësi ose elemente arbitrariteti të një shkalle të tillë sa të cenojnë këtë të drejtë.

79. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 04.06.2026

Shpallur më 20.07.2026

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me nr. 5 (R) 2025 të Regjistrit Themeltar, me kërkuese Renisa Selenicën, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 5442, datë 18.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vendimit nr. 00-2024-5194 (851), datë 23.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr. 851/2024*), si të papajtueshme me Kushtetutën, unë, gjyqtarja Marjana Semini, jam kundër vendimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në ndryshim nga shumica, çmoj se pretendimet e kërkueses lidhur me vendimmarrjet e gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Lartë, në pjesën që kanë nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar kërkimin për zgjidhjen e pasojave të martesës në drejtim të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, janë të bazuara. Për rrjedhojë, në vijim do të parashtroj argumentet mbi të cilat bazohet qëndrimi im i mbetur në pakicë në këtë çështje.

2. Në vlerësimin tim, vendimmarrjet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë çuar në cenimin e së drejtës së kërkueses për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, shkak për të cilin çmoj se

Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës së kërkuases, duke shfuqizuar vendimin nr. 851/2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë për këtë kërkim.

3. Në analizë të çështjes, fillimisht po evidentoj se thelbi i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi kushtetues ka të bëjë me nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të një pjese të objektit të padisë për zgjidhje martese, e cila lidhet me kërkimin për zgjidhjen e pasojave të martesës në drejtim të ushtrimit prej nënës, shtetase shqiptare, të përgjegjesisë prindërore për fëmijën e mitur nga martesa e saj me subjektin e interesuar, babain e fëmijës, shtetas belg. Ky proces është vënë në lëvizje në Shqipëri nga kërkuësja, e cila, në datën 05.08.2022, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesëpadi për zgjidhjen e martesës dhe lënien asaj të fëmijës për rritje dhe për edukim. Në gjykim, subjekti i interesuar, babai i fëmijës, ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, me pretendimin se ajo ishte çështje me elemente të huaja, për shkak të lidhjes së martesës në Belgjikë, shtetësisë belge të tij dhe të fëmijës, si dhe të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës në shtetin belg, në të cilin po zhvillohej edhe një proces gjyqësor, nisur prej tij më 03.10.2022 (pra, gati dy muaj më vonë se procesi civil në Shqipëri) dhe me objekt, ndër të tjera, kërkimin për ushtrimin e përgjegjesisë prindërore.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pranuar kërkesëpadinë e kërkuases vetëm në pjesën që kishte për objekt zgjidhjen e martesës ndërmjet palëve, ndërsa për pjesën e padisë që lidhet me rregullimin e pasojave në drejtim të përgjegjesisë prindërore, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar me arsyetimin se në kushtet kur me vendime gjyqësore ishte vendosur kthimi i fëmijës në vendbanimin e zakonshëm në Belgjikë, në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Konventës së Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005 (në vijim Konventa e Hagës për Përgjegjësinë Prindërore), si dhe të nenit 59 të KPC-së, juridiksioni për shqyrtimin e kësaj çështjeje u përkiste tashmë gjykatave belge.

5. Ndërkohë, në vlerësim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuësja në rekurs për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë në këtë vendim ka pranuar se “vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës” përbën një çështje fakti që vlerësohet rast pas rasti, duke evidentuar se, në raste të tilla, duhet të merren në konsideratë: (i) lidhja e qëndrueshme e fëmijës me një vend të caktuar; (ii)

marrëdhëniet familjare e shoqërore; (iii) rrethana të tjera të rëndësishme. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 5 dhe 7 të *Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*, juridiksioni për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijës u përkiste autoriteteve të shtetit belg ku fëmija kishte vendqëndrimin e zakonshëm dhe ato vazhdonin të ruanin këtë juridiksion për shkak të largimit/mbajtjes pa të drejtë të fëmijës nga kërkuesja, meqenëse fëmija kishte qenë banor i përhershëm në Belgjikë përpara largimit ose mbajtjes me pa të drejtë. Për rrjedhojë, në rastin konkret, shtetësia shqiptare e fëmijës dhe qëndrimi i tij faktik në Shqipëri nuk mjaftonin për të përcaktuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

6. Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual, shumica ka evidentuar rregullimet e kuadrit normativ të brendshëm dhe atij ndërkombëtar që parashikon: së pari, detyrimin e gjykatave shqiptare për përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në rastet e zgjidhjes së martesës mes bashkëshortëve si pasojë e kësaj të fundit (*neni 226 i KF-së, i cili referon në Kreun III të këtij kodi me titull "Pasojat e zgjidhjes së martesës"*); së dyti, rregullimin e: a) marrëdhënieve prind-fëmijë nga ligji i shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm ose nga ligji i shtetësisë së fëmijës, kur ky i fundit mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës; b) zgjidhjen nga gjykatat shqiptare të mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë (përveçse kur rregullat e posaçme parashikojnë ndryshe), kur njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar ose kur bashkëshorti kundër të cilit është ngritur padia, ose paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, juridiksion ky që shtrihet edhe mbi pasojat e zgjidhjes së martesës, si dhe mbi masat e përkohshme që merren nga gjykata në këto raste (*nenet 29, 71, 72 e 75 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare*); së treti, a) rregullimin e juridiksionit të autoriteteve gjyqësore ose administrative të shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme për marrjen e masave për mbrojtjen e tij/saj dhe kalimin e këtij juridiksioni autoriteteve të shtetit të banesës së re të përhershme të fëmijës në rast të ndryshimit të saj (banesës së përhershme) në një shtet tjetër kontraktues, përveç rastit të largimit ose mbajtjes me pa të drejtë të fëmijës; b) në rastet e largimit ose mbajtjes me pa të drejtë të fëmijës, ruajtjen e juridiksionit të autoriteteve të shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme menjëherë para largimit ose mbajtjes, derisa fëmija të ketë marrë një banesë të përhershme në një shtet tjetër dhe [...] të ketë qëndruar në shtetin e ri për një periudhë prej jo më pak se një vit, [...] e të jetë integruar në mjedisin e ri; c) transferimin ose marrjen e juridiksionit nga

autoritetet e shtetit tjetër kontraktues, kur, në raste të veçanta, vlerësohet se këto të fundit janë më mirë të vendosura për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës dhe për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse; ç) frenimin nga ushtrimi i juridiksionit nga autoritetet e një shteti kontraktues që ka juridiksion, nëse në kohën e fillimit të procedimit masa korresponduese janë kërkuar nga autoritetet e një shteti tjetër kontraktues që ka juridiksion dhe janë ende në proces shqyrtimi (*nenet 5-13 të Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*).

7. Nën dritën e këtij kuadri normativ, shumica ka evidentuar përmbajtjen e neneve 5 dhe 7 të *Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*, sipas të cilave juridiksioni për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore përcaktohet nga vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës dhe parimi i afërsisë. Sipas këtij parimi, vlerësoj se, në mungesë të pranimi të largimit ose mbajtjes së fëmijës nga personi që ka të drejta kujdestarie/përgjegjësie prindërore, juridiksioni i kalon shtetit të vendqëndrimit të ri të zakonshëm kur fëmija ka qëndruar në këtë shtet të paktën një vit dhe është integruar në mjedisin e ri. Megjithatë, shumica ka vlerësuar në thelb të analizës së dispozitave të mësipërme, se në rastet e largimit ose mbajtjes me pa të drejtë të fëmijës nga njëri prind, ky juridiksion do të ushtrohet nga shteti ku fëmija ka marrë vendqëndrimin e ri të zakonshëm vetëm në rastin kur nuk ka në shqyrtim një kërkesë për kthimin e fëmijës, duke e trajtuar rastin si përjashtimor, meqenëse faktikisht nëna e ka mbajtur në mënyrë të padrejtë fëmijën, ndonëse në fund Gjykata shprehet se rrethanat e reja faktike nuk mund të injorohen plotësisht (*shih paragrafët 70-71 të vendimit*). Po kështu, në vlerësimin që u ka bërë shumica vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, arrihet në konkluzionet se: (i) kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijës në Shqipëri nuk mund të vlerësohet e shkëputur nga fakti që, brenda 6 ditëve nga momenti kur është vënë në dijeni për vendimin e kërkuar për moskthimin në Belgjikë, subjekti i interesuar ka kërkuar kthimin e fëmijës në Belgjikë; (ii) neni 226 i KF-së nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të përcaktuar juridiksionin e gjykatave shqiptare, kurse neni 10 i *Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore* e kushtëzon juridiksionin e gjykatës së divorcit me pranimin e këtij juridiksioni nga prindërit, si dhe vlerësimin se ushtrimi i tij është në interesin më të lartë të fëmijës (*shih paragrafët 71-72 të vendimit*).

8. Lidhur me sa më sipër, vlerësoj se shumica përdor një arsyetim ngushtësisht të lidhur me një kriter siç është ai i vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës, por pa vlerësuar *statusquo*-në e këtij vendqëndrimi dhe pasojat e kësaj në zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Kjo analizë është e lidhur me faktin se, nga njëra anë, Gjykata pranon se kur fëmija qëndron mbi një vit në një vendqëndrim të ri dhe është integruar në mjedisin e ri, sipas kuadrit konventor të sipërpërmendur juridiksionin e ka gjykata e vendbanimit të ri, dhe kjo

gjë nuk duhet të “... *injorohet plotësisht*.”, ndërsa, nga ana tjetër, me rrëzimin e kërimit në fakt nuk merr fare në konsideratë këto rrethana të reja të cilat lidhen në mënyrë të mirëfilltë me interesin më të lartë të fëmijës, mirëqenien e fëmijës, sjelljen dhe qëndrimin e fëmijës dhe jo me sjelljen dhe qëndrimin e nënës që e mban atë në mënyrë të padrejtë, ose me faktin që ka një kërkim nga ana e babait për kthimin e fëmijës. Në analizën që u bëj vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm vërej se, megjithëse ato e kanë pranuar se juridiksioni zgjidhet rast pas rasti, dhe kanë listuar si faktorë të rëndësishëm kriteret që duhen analizuar në çdo rast konkret, të tilla si: lidhjen e qëndrueshme të fëmijës me një vend të caktuar, marrëdhëniet familjare e shoqërore të krijuara, si dhe rrethana të tjera të rëndësishme - në asnjë moment nuk kanë analizuar mënyrën sesi këto kriterë konkurronin me njëra-tjetrën për të përcaktuar nëse kishin ose jo juridiksion.

9. Për sa më sipër, për sa kohë *Konventa për të Drejtat e Fëmijës (neni 3, pika 1)* dhe kuadri ligjor i zbatueshëm e ka parashikuar si parim të rëndësishëm interesin më të lartë të fëmijës, i cili duhet të jetë *konsiderata mbizotëruese* në çdo vendim që ka të bëjë me fëmijën të autoriteteve publike, dhe, po ashtu, edhe shumica me të drejtë në arsyetimin e vendimit e ka pranuar këtë parim si një garanci kushtetuese të parashikuar nga neni 54 i Kushtetutës dhe të reflektuar edhe në instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme, përsëri, siç duket, arrin në përfundimin se në çështjet familjare me elemente të huaja parimi i interesit më të lartë të fëmijës nuk vepron si kriter autonom dhe as mund të zbatohet i shkëputur nga rregullat e juridiksionit që përcaktojnë autoritetin kompetent, por duhet vlerësuar në tërësi me rrethanat e tjera të çështjes (*shih paragrafët 66 dhe 77 të vendimit*). Duke vlerësuar si më sipër, shumica i ka gjetur të drejta vendimmarrjet e kundërshtuara nga kërkuuesja, me arsyetimin se në nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të kërimit për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë kanë marrë parasysh rrethanat përcaktuese të rastit, përfshirë elementet e huaja të marrëdhënies juridike, vendimmarrjet gjyqësore për kthimin e fëmijës në Belgjikë, vendimin e gjykatës belge për ushtrimin e përkohshëm të autoritetit prindëror dhe dispozitat e *Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore* duke i arsyetuar mjaftueshëm këto vendimmarrje.

10. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk plotëson standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk u jep përgjigje pretendimeve të kërkueses në raport me rrethanat konkrete të çështjes, në cenim të së drejtës së saj për akses në ato gjykata. Qëndrimin tim në pakicë e mbështes në argumentet që do të parashtrohen në vijim.

11. *Së pari*, nga pikëpamja procedurale, *lidhur me juridiksionin* ndryshe nga sa shumica ka arsyetuar, nuk rezulton që *Konventa e Hagës për Përgjegjësinë Prindërore* ose ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar i zbatueshëm të përcaktojë detyrimin e gjykatave të vendqëndrimit të ri të fëmijës, (*në rastin konkret të gjykatave shqiptare*), për të hequr dorë nga juridiksioni i tyre, për shkak të juridiksionit të autoriteteve të vendqëndrimit të mëparshëm të fëmijës. Përkundrazi, rregullat konventore synojnë koordinimin dhe shmangien e konflikteve të juridiksionit ndërmjet shteteve kontraktuese, por nuk përjashtojnë kompetencat që ligji i brendshëm u njeh gjykatave të vendqëndrimit të ri të fëmijës për çështjet familjare me elemente të huaja. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vetë konventa parashikon mekanizma bashkëpunimi, komunikimi dhe transferimi juridiksioni ndërmjet autoriteteve shtetërore (*shih nenet 1, pika 1, shkronja “e”, 8, 9 dhe Kapitullin V të Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*), çka tregon se juridiksionet mund të bashkekzistojnë dhe të koordinohen në funksion të mirëqenies dhe mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës. Për këtë arsye, vlerësoj se konkluzioni i gjykatave të zakonshme se juridiksioni për përcaktimin e përgjegjësisë prindërore u përkiste autoriteteve belge nuk rezulton i mbështetur në një analizë të plotë të kuadrit ligjor dhe konventor të zbatueshëm, sepse në fakt nuk ka asnjë parashikim ligjor në kuadrin kombëtar ose ndërkombëtar që të ndalojë juridiksionin e gjykatave shqiptare në një rast të tillë. Kjo do të thotë që juridiksioni mund t’u përkasë gjykatave shqiptare, po aq sa mund t’u përkasë edhe gjykatave belge. Madje për sa kohë objekti i kërimit ishte zgjidhja e martesës dhe e pasojave të saj, gjykatat shqiptare nuk kanë respektuar shkronjën “a” të nenit 75 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private që parashikon se ato kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën, ndër të tjera, kur njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar.

12. Nëse gjykatat shqiptare kishin dyshime serioze për juridiksionin e tyre ose interpretimin e dispozitave të sipërpërmendura të *Konventës së Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*, ato nuk duhej të kufizoheshin në shpalljen e mungesës së juridiksionit. Vetë mekanizmat e kësaj konvente parashikojnë bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të shteteve kontraktuese dhe mundësinë e kërimit të informacionit, ose konsultimit me autoritetet e shtetit tjetër. Në këto rrethana, përpara se të vendosnin mosshqyrtimin e këtij kërkit, gjykatat shqiptare duhej të kishin vlerësuar mundësinë e komunikimit institucional me autoritetet belge, me qëllim sqarimin e çështjeve që lidheshin me juridiksionin dhe interesin më të lartë të fëmijës.

13. *Së dyti*, në lidhje me *objektin e padive me natyrë familjare* që lidhet drejtpërdrejt me çështjen se cili juridiksion do të zbatohet në gjykimin e një mosmarrëveshjeje familjare

mund të ndodhemi përpara dy rasteve që përmbajnë kërkimin për përgjegjësinë prindërore për fëmijën e mitur: (1) kur kërkohet me padi zgjidhja e martesës dhe zgjidhja e pasojave të saj, përfshirë edhe përgjegjësinë prindërore; (2) kur objekt i kërimit është vetëm caktimi ose ndryshimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, që përbën një kërkim që mund të bëhet i mëvetshëm *per se* edhe pas zgjidhjes së martesës. Bashkohem me rëndësinë që i jep shumica përcaktimit të “vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës”, por ndahem prej tyre se nuk e vlerësoj “vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës” si faktorin e vetëm dhe determinant për përcaktimin e juridiksionit për gjykimin e çështjes. Kriter po aq i rëndësishëm është vlerësimi nga gjykatat i interesit më të lartë të fëmijës veçanërisht i lidhur me balancën që krijohet mes “vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm” me “vendbanimin e ri” që me sa duket ka marrë *de facto* atë të vendqëndrimit të zakonshëm si dhe ndikimin që ka mbi fëmijën e mitur kohëzgjatja e qëndrimit në secilin prej këtyre vendbanimeve. Në vazhdim të analizës së dy rasteve/skenarëve të mësipërm vlerësoj se, ndërsa në rastin e dytë, pa asnjë diskutim, vlen të analizohet dhe të merret në konsideratë se cili është “vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës”, në rastin e parë duhet mbajtur në vëmendje se gjykata ka gjithmonë juridiksion, për sa kohë në themel të gjykimit është zgjidhja e martesës dhe e pasojave të saj dhe është në diskrecionin e saj që të vendosë për juridiksionit varësisht mundësisë që ka për zbatimin me kujdesin e duhur të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Pra, ekziston edhe mundësia që gjykata shqiptare ta nxjerrë një rast të tillë jashtë juridiksionit, por për ta bërë këtë duhet që nga rrethanat e faktit të rastit konkret të rezultojë se ka rrethana të caktuara me karakter objektiv dhe/ose vetë palët ndërgjyqëse (bashkëshortët) kanë ndikuar për t’i krijuar gjykatës vështirësi në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës të lidhur me mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës së mitur. Kjo nuk rezulton të jetë analizuar fare në rastin konkret dhe as nuk është arsyetuar nga gjykatat në këtë këndvështrim. Në vlerësimin tim, konkluzioni i gjykatave shqiptare është arritur pa përfillur vlerësimin e rrethanave specifike të fëmijës në rastin konkret dhe kjo nuk u korrigjua as nga Gjykata.

14. Në vlerësimin tim, gjykatat nevojitej të analizonin sesa rëndësi ka juridiksioni *per se* nëse jemi në një situatë konflikti mes kuptimit të vendqëndrimit të zakonshëm në kuptimin e të shkuarës dhe që lidhet me periudhën e qëndrimit në Belgjikë të fëmijës dhe vendqëndrimit aktual në Shqipëri të fëmijës për të përcaktuar se cili do të vlerësohej si vendqëndrimi i zakonshëm në kushtet e reja qoftë këto edhe të lidhura me moskthimin e fëmijës nga ana e nënës dhe mosveprimin e autoriteteve shqiptare dhe jo për faj të fëmijës. Në këtë rast, për interesin më të lartë të fëmijës, nevojitej një analizë e plotë duke i dhënë peshën e duhur njërit ose tjetrit vendqëndrim në funksion të interesit të fëmijës dhe pasojave që vijnë mbi fëmijën

nga moszbatimi në kohë i vendimit të kthimit, çka ka sjellë një klasifikim të ri të Shqipërisë si vendbanim i zakonshëm. Po kështu, në raste të tilla është e rëndësishme të vlerësohet nga gjykatat sesa vëmendje kanë treguar autoritetet gjyqësore shqiptare në këtë analizë; sa rezistent është vendqëndrimi i zakonshëm në Belgjikë tashmë i kapërcyer për shkak të kohës që ka kaluar fëmija në Shqipëri, kundrejt vendqëndrimit të ri të fituar si gjendje faktike, por edhe juridike dhe sesa ndikon kjo në ripozicionimin e autoriteteve në çështje të juridiksionit të lidhura me përgjegjësinë prindërore, si dhe nëse kthimi i fëmijës ka dalë ose jo në plan të dytë për shkak të vonesave dhe të nevojës imediate për rregullimin e të drejtave të fëmijës për marrëdhënie dhe kontakt me prindin dhe rregullimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

15. Së treti, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë marrë në konsideratë natyrën e veçantë të kërimit për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore si një nga pasojat e pashmangshme dhe të drejtpërdrejta të zgjidhjes së martesës. Kështu, dispozitat e KF-së për zgjidhjen e martesës nuk e shkëpusin zgjidhjen nga disa pasoja që rregullohen së bashku me të. Neni 226 i KF-së, i lexuar në lidhje me nenin 155 të këtij kodi, parashikon, si pasojë të zgjidhjes së martesës, edhe detyrimin e gjykatave për përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës. Në këtë drejtim, sipas nenit 155 të KF-së, gjykatat kanë detyrimin që, përpara marrjes së një vendimi, të thërrasin një psikolog ose punonjës social, i cili, përpara se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë ish-bashkëshortët dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija. Pra, nga shumica nuk është marrë si duhet në konsideratë fakti se nuk jemi përpara rastit ku kërkimi ka si objekt caktimin ose ndryshimin e përgjegjësisë prindërore, por jemi përpara padisë me objekt zgjidhjen e martesës dhe të pasojave të saj, (në drejtim të lënies së fëmijës në ngarkim të nënës), ndërkohë kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zgjidhur martesën mes ish-bashkëshortëve dhe kanë vendosur mosshqyrtimin e kërimit për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke e lënë pa zgjidhje këtë pasojë, pjesë të çështjes objekt mosmarrëveshjeje.

16. Për rrjedhojë, për sa më sipër, vlerësoj se në çdo rast gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të shmangin ose të veçojnë kërkimin për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke zgjidhur në mënyrë të njëanshme vetëm zgjidhjen e martesës. Në të kundërt, gjykatat duhet të kishin arsyetuar në vendimmarrjet e tyre se përse një zgjidhje e tillë nuk ishte e mundur. *Konventa e Hagës për Përgjegjësinë Prindërore* ka përcaktuar dhe ka evidentuar edhe tri rrugëzgjidhje për secilën prej rasteve që mund të ndodhin në praktikë: (i) ruajtjen e juridiksionit të autoriteteve të shtetit kontraktues ku fëmija ka banesën e përhershme; (ii) transferimin ose marrjen e juridiksionit nga autoritetet e shtetit tjetër

kontraktues; (iii) frenimin nga ushtrimi i juridiksionit nga autoritetet e një shtetit kontraktues që ka juridiksion. (*shih për më tepër paragrafin 6 të këtij mendimi pakice*). Gjykatat shqiptare të juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë analizuar kriteret për të evidentuar se me cilin rast po përballej shqyrtimi gjyqësor, por janë mjaftuar me rastin e parë dhe e kanë konsideruar atë të mirëqenë.

17. *Së katërti*, pa u ndalur në analizën dhe *trajtimin e këtyre rrethanave të reja*, gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë kryer një vlerësim krahasues rreth mjedisit social e familjar të fëmijës në secilin shtet, lidhjet sociale, familjare, emocionale të krijuara nga fëmija në Shqipëri ose ndikimin e ndryshimit të menjëhershëm të mjedisit ku ishte rritur, duke pasur parasysh faktin se nga të dhënat në dosje rezulton se fëmija është i datëlindjes 04.09.2020 dhe kishte ardhur në Shqipëri në korrik 2022, ndërsa në momentin e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të rekursit të kërkuës, fëmija kishte rreth 2 vjet e 5 muaj që jetonte në Shqipëri. Në këtë kontekst, në kohën e transferimit në Shqipëri fëmija ishte ende në vitet e para të jetës, çka nënkupton se, për shkak të moshës së vogël, nuk mund të thuhet se kishte krijuar marrëdhënie sociale ose një nivel të tillë integrimi në Belgjikë që çonte në përfundimin se lidhja personale, emocionale dhe sociale vazhdonte të ishte me atë shtet. Një analizë dhe arsyetim i kujdesshëm nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk duhet të linte në heshtje çështjet që lidhen me rrethanat specifike në drejtim të interesit më të lartë të fëmijës që shtrohen në këtë rast konkret, të tilla: si ndikonte kalimi i kohës nga ardhja e fëmijës në Shqipëri në moshën gati 22-muajshe dhe largimi pas 2 vjetësh e 5 muajsh nga Shqipëria; në cilat marrëdhënie shoqërore ose familjare ishte përfshirë fëmija në Shqipëri; nëse kishte frekuentuar institucione të edukimit parashkollor; nëse fëmija fliste vetëm gjuhën shqipe ose edhe atë flamande; nëse kishte ruajtur një komunikim me babain *online* ose ky komunikim mungonte; nëse nëna e fëmijës kishte mundësitë ekonomike, sociale dhe edukative për të siguruar mirërritjen dhe miredukimin e fëmijës dhe në mënyrë të ndërsjelltë ta vlerësonte këtë gjë edhe për babain. E ndjej shumë të rëndësishme që të nënvizoj se, në raste të tilla, kur mosmarrëveshjet familjare prekin interesat e fëmijëve, gjykatat duhet të vlerësojnë si prioritar interesin më të lartë të fëmijës dhe jo interesat e prindërve ose “*të ndëshkojë*” moszbatimin vullnetar të vendimit të kthimit të fëmijës nga ana e nënës dhe mosveprimin e autoriteteve shqiptare për ekzekutimin e këtij vendimi me kosto te vetë fëmijët. Çdo analizë e interesave të këtyre të fundit duhet të kryhet vetëm dhe vetëm në funksion të interesit të fëmijës. Në raste të tilla ekziston gjithmonë mundësia që çështja të nxirret jashtë juridiksionit, por kjo gjë ndodh vetëm atëherë kur gjykata shqiptare do ta kishte të pamundur vlerësimin e interesit të fëmijës ose do të konkludonte se është në

interesin e fëmijës që çështja të gjykohet nga gjykatat belge. Jemi në rastin kur fëmija kishte 2 vjet e 5 muaj që jetonte në Shqipëri.

18. Këto gjykata janë mjaftuar me një arsyetim formal referuar vendimmarrjeve për kthimin e fëmijës, pa shpjeguar nëse situata e re faktike e krijuar ishte e tillë që ndikonte në përcaktimin e juridiksionit të tyre. Gjatë kësaj periudhe fëmija kishte mësuar dhe fliste gjuhën shqipe, ishte regjistruar në institucionet shqiptare, ndiqte sistemin arsimor shqiptar dhe ishte përshtatur me mjedisin e ri, rrethana këto faktike që, sipas kuptimit të nocionit të “*vendqëndrimit të zakonshëm*”, përbëjnë tregues të rëndësishëm të integritetit social dhe familjar të fëmijës në vendqëndrimin e ri në Shqipëri si qendra kryesore e jetës dhe veprimtarisë së tij. Po kështu, në kuadër të standardit kushtetues e konventor të interesit më të lartë të fëmijës, gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë kushtet e jetesës të ofruara për fëmijën nga secili prind, mundësitë e tyre ekonomike për mbarëvajtjen dhe edukimin e fëmijës, procesin arsimor në secilin shtet ose rrethana të tjera të rëndësishme për përcaktimin e juridiksionit. Në këtë drejtim, në jurisprudencën e saj njësuere për çështje të ngjashme Gjykata e Lartë ka pranuar se rritja e vëmendjes ndaj të drejtave të fëmijës, veçanërisht e së drejtës për t’u dëgjuar, e garantuar nga instrumentet ndërkombëtare, kërkon një “zhvendosje” nga zbatimi thjesht teknik i rregullave të juridiksionit, drejt një qasjeje të orientuar nga fëmija, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të tij/saj, të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar në të gjitha procedurat vendimmarrëse që lidhen me të, si dhe të drejtën për të ruajtur marrëdhënie personale me secilin prind (*shih vendimin njësuere nr. 00-2025-4900 (621), datë 22.12.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kontekst, në mungesë të kësaj analize, çmoj se konkluzioni i gjykatave të zakonshme për mungesën e juridiksionit nuk ka marrë në konsideratë rrethanat e veçanta në vendbanimin e ri që ndikonin drejtpërdrejt në interesin më të lartë të fëmijës.

19. Së fundmi, dështimi i autoriteteve shqiptare në zbatimin e Konventës së Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës (*Konventa e Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës*) nuk mund të ndikojë ose të faturohet në favor të zvogëlimit të rëndësisë së parimit të interesit më të lartë të fëmijës ose mungesë vlerësimi të këtij interesi, sepse fëmija nuk është një objekt që thjesht “stacionohet” në shtet të caktuar, por është një subjekt i së drejtës që jeton, zhvillohet, edukohet, emocionohet, komunikon dhe ndërvepron me të gjithë mjedisin e ri duke u bërë pjesë e tij dhe përshtatur me të në atë nivel sa e kthen këtë në një vendqëndrim të zakonshëm (*Habitual Residence*). Në rastin konkret, dhe në kushtet e moszbatimit të kërkesave të Konventës së Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës, së cilës i referohet edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*) është Konventa e

Hagës për Përgjegjësinë Prindërore ajo që bën përgjegjëse Shqipërinë si vendin që ka juridiksion për përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, sepse tashmë fëmija e ka fituar këtë vendqëndrim të ri dhe ka të drejtë për marrëdhënie të rregulluara me prindërit.

20. Konstatohet lehtë që shpejtësia e kërkuar nga *Konventa e Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës* në procedim dhe afatet e shkurtra dhe procedurat e shpejta të parashikuara nga kjo konventë nuk janë zbatuar nga autoritetet publike. Efektet e vonësive në thelbin e kuptimit të “vendqëndrimit të zakonshëm” kanë bërë që fëmija të përshtatet në një mjedis të ri, pra është akomoduar në një vendbanim që ka marrë statusin e një vendbanimi të qëndrueshëm për të. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e shtruan asnjëherë pyetjen se ku është fëmija, cila është faza e ekzekutimit të vendimit të kthimit, çfarë ndodh me interesin më të lartë të fëmijës kur kanë kaluar plot 2 vjet e 5 muaj që nga ardhja e fëmijës në Shqipëri. Po kështu, këto gjykata nuk e shtruan asnjëherë as pyetjen nëse lidhja e fëmijës me Shqipërinë përbënte një vendosje të fëmijës në një mjedis të ri, sikurse shprehet *Konventa e Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës*¹.

21. Ndonëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i japin me të drejtë më shumë rëndësi kthimit të fëmijës sipas *Konventës së Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës*, por nga ana e tyre është neglizhuar analiza e një fakti shumë të rëndësishëm që, duke kaluar një afat prej 2 vjetësh e 5 muajsh, ka bërë që procedura, kërkesat dhe efektet e kërkuara prej kësaj konvente të mbeten pa fuqi dhe që insistimi në rastin konkret në zbatimin e *Konventës së Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës* në kushtet e reja cenon interesin e tij. Kuptimi i nenit 12 të kësaj konvente duhet lexuar e zbatuar me kujdes, sepse në rastin konkret nuk jemi në kushtet e këtij neni për sa i përket fillimit të procedimit, sepse procedimi për kthim nuk ka pasur fare vonesa. Nga analiza në tërësi e nenit 12 vihet re se në të gjendet kufiri lejues dhe kufiri i përfundimit të zbatimit të saj. Kufiri lejues është atëherë sa kthimi ka vlerë dhe nuk cenon interesin e fëmijës dhe shtrihet deri në rastin kur procedimi ka nisur brenda më pak se një viti nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë, ose pas mbarimit të periudhës së një viti (kjo fundit nuk lidhet me rastin në shqyrtim). Por në të njëjtën kohë, *Konventa e Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës* ka përcaktuar edhe kufirin jashtë të cilit kthimi humbet vlerën dhe që lidhet me ato raste kur vonesat objektive ose

¹ Shënim: Më konkretisht, Konventa e Hagës në nenin 1 parashikon: Qëllimet e kësaj Konvente janë: a) të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin kontraktues. Po kështu, në nenin 11, pikat 1 dhe 2, parashikojnë: 1. Autoritetet gjyqësore ose administrative të shteteve kontraktuese do të shpejtojnë procedurat për kthimin e fëmijëve. 2. Nëse autoriteti përkatës administrativ apo gjyqësor nuk ka arritur një vendim brenda një periudhe gjashtëjavore nga data e fillimit të procedimit, aplikanti ose autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, me nismën e vet, ose nëse i kërkohet nga autoriteti qendror i shtetit kërkues, do të ketë të drejtën të kërkojë një deklaratë për shkaqet e vonësës. Nëse merret një përgjigje nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, ky autoritet do t’ia transmetojë, sipas rastit, përgjigjen autoritetit qendror të shtetit kërkues ose aplikantit..

subjektive në kthim kanë bërë të mundur krijimin për fëmijën të një “mjedisi të ri”, siç është rasti i Shqipërisë.²

22. Në konkluzion të analizës së mësipërme, vlerësoj se korniza ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe dispozitat e tyre që ndikojnë në zgjidhjen e këtij rasti, jo vetëm nuk mund të zbatohen në mënyrë selektive, por duhet të lexohen dhe të zbatohen të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, për të kuptuar drejt se në cilin rast zbatimi i njëres e përjashton tjetrën, apo për të kuptuar se mungesa e një kushti ose kriteri, apo tejkalimi i një afati e bën normën dhe aktin të pazbatueshëm në atë rast dhe në me pasoja në cenim të interesit të fëmijës. Për këto arsye, vlerësoj se kur synojmë të analizojmë qëllimin e normës konkrete, duhet ta zbërthejmë në mënyrë të kujdesshme përmbajtjen e saj për të kuptuar rast pas rasti sesi zbatohen skenarët e mundshëm që ajo rregullon me qëllimin për të gjetur në mënyrë të saktë sesi konkurrojnë afatet kohore me veprimet dhe mosveprimet e prindërve dhe autoriteteve publike dhe për të arsyetuar në mënyrë të plotë për mënyrën e përmbushjes së detyrimeve pozitive të shteteve. Vlen të theksohet se mbi interesin e fëmijës nuk duhet të rëndojnë as sjelljet e gabuara dhe mosmarrëveshjet e prindërve, ashtu si kundër nuk duhet të rëndojnë as dështimet e autoriteteve publike që përfshihen në procedurat për kthimin e fëmijës, ose ato për zgjidhjen e përgjegjësisë prindërore. Edhe sikur për një moment të konstatohet një gabim ose një dështim në veprimet e autoriteteve publike, autoriteti i radhës në zinxhirin procedural të proceseve ku ndërthuret interesi më i lartë i fëmijës duhet të marrë masa brenda kompetencave që ka për t’i korrigjuar, gjë që nuk ndodhi në rastin konkret në asnjë hallkë të këtij zinxhiri.

23. Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësoj se gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë kryer një analizë të plotë të rrethanave faktike dhe juridike të çështjes, duke mos u dhënë përgjigje të bazuar në analizë pretendimeve thelbësore të kërkuases në lidhje me vendqëndrimin aktual të fëmijës dhe rrethanat e reja e specifike që mund të kenë sjellë integrimin në Shqipëri nën dritën e respektimit dhe të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, ndërldhjen e zgjidhjes së martesës me përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit të parashikuar nga *Konventa e Hagës për Përgjegjësinë Prindërore*. Për këtë arsye, vlerësoj se vendimmarrjet e kundërshtuara nuk përmbushin standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në cenim të së drejtës

² Neni 12 parashikon: “Kur fëmija është larguar ose mbahet padrejtësisht, siç është parashikuar në nenin 3, dhe kur në datën e fillimit të procedimit para autoritetit gjyqësor apo administrativ të shtetit kontraktues ku fëmija ka kaluar më pak se një vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë, autoriteti i interesuar do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës. Edhe kur procedimet kanë filluar pas mbarimit të periudhës së një viti, siç referohet në paragrafin e mësipërm, autoriteti gjyqësor ose administrativ do të urdhërojë kthimin e fëmijës, për sa kohë që nuk është provuar se ai tashmë është vendosur në një mjedis të ri të tij.

së kërkueses për akses në gjykatë. Për rrjedhojë, kërkesa duhej të ishte pranuar dhe çështja duhej të ishte dërguar për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Anëtare: **Marjana Semini**